



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.98**

**2 gusht**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9777 datë 16.7.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin vjetor rajonal Cards 2006 të asistencës komunitare, për autoritetet tatimore dhe doganore të Ballkanit Perëndimor” .....	2783
Ligj nr.9778 datë 16.7.2007	Për ratifikimin e “Konventës tripalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë për sistemin e naftës-jellësit transballkanik” .....	2796
Ligj nr.9782 datë 19.7.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për projektin e rrugës Milot-Rrëshen” .....	2805

**LIGJ**  
**Nr.9777, datë 16.7.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE  
EUROPIANE PËR PROGRAMIN VJETOR RAJONAL CARDS 2006 TË ASISTENCËS  
KOMUNITARE, PËR AUTORITETET TATIMORE DHE DOGANORE TË BALLKANIT  
PERËNDIMOR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin vjetor rajonal CARDS 2006 të asistencës komunitare, për autoritetet tatimore dhe doganore të Ballkanit Perëndimor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5420, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE FINANCIARE**  
**KUSHTE SPECIFIKE**

Komuniteti Europian, këtu e tutje referuar si “Komuniteti”, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu e tutje referuar si “Komisioni”, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këtu e tutje referuar si “Përfituesi”, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

**Natyra dhe qëllimi i veprimit**

1.1 Komuniteti do të kontribuojë për financimin e programit vjetor të veprimit CARDS 2006 të asistencës komunitare për autoritetet tatimore dhe doganore të Ballkanit Perëndimor, këtu e tutje referuar si “Programi”, i cili është përshkruar në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

1.2 Ky Program do të zbatohet në përputhje me Marrëveshjen Financiare dhe shtojcat e saj: kushtet e përgjithshme (shtojca I) dhe dispozitat teknike dhe administrative (shtojca II).

Neni 2

**Kontributi financiar i Komunitetit**

2.1 Kostoja totale e Programit është 14 milionë euro.

2.2 Komuniteti merr përsipër financimin maksimalisht prej 14 milionë euro. Ndarja e kontributit financiar të Komunitetit sipas zërave të buxhetit është përshkruar në buxhetin e përfshirë në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II.

Neni 3  
**Kontributi i Përfituesit**

Aty ku një pjesë apo i gjithë kontributi i Përfituesit është i një natyre jo financiare, rregullat e detajuara do të përcaktohen në dispozitat teknike dhe administrative në shtojcën II të Marrëveshjes Financiare.

Neni 4  
**Periudha e ekzekutimit**

Data përfundimtare e zbatimit të projekteve nën këtë propozim është 31.12.2014. Rrjedhimisht të gjitha aktivitetet, përfshirë kontraktimet, pagesat, monitorimet, auditin dhe vlerësimin duhet të përfundojnë brenda datës 31.12.2014.

Neni 5  
**Afati për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes Financiare**

Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare do të nënshkruhen brenda datës 6.6.2009. Ky afat nuk mund të shtyhet. Kjo normë nuk zbatohet për kontratat e auditimit dhe vlerësimin, të cilat mund të nënshkruhen me vonë.

Neni 6  
**Adresat**

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes Financiare do të jenë me shkrim, do t'i referohen shprehimisht Programit dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

a) për Komisionin:

Z.Dirck Meganeck

Drejtor

Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit:

CHAR 04/99

B-1049 Bruksel, Belgjikë,

Fax: +32 2 295 74 82

b) për Përfituesin:

Znj.Arenca Trashani

Ministre e Integritimit Europian

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"

Tiranë, Shqipëri

Fax: +355 4 25 62 67

Neni 7  
**Shtojcat**

7.1. Dokumentet e mëposhtme do t'i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje dhe do të bëhen pjesë përbërëse e saj:

Shtojca I: Kushtet e përgjithshme

Shtojca II: Dispozitat teknike dhe administrative

7.2. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcave dhe atyre të kushteve specifike të Marrëveshjes Financiare, dispozitat e kushteve specifike do të kenë përparësi. Në rast të një konflikti midis dispozitave të shtojcës I dhe atyre të shtojcës II, dispozitat e shtojcës I do të kenë përparësi.

Neni 8  
**Kushte të tjera specifike të zbatueshme për Programin**

8.1. Kushtet e përgjithshme plotësohen nga dispozitat e mëposhtme:

Me qëllim që të sigurohet një zbatim efektiv i kësaj Marrëveshjeje Financiare, Përfituesi do të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

- ekspertët e kontraktuar nga Komisioni për zbatimin e Programit lidhur me këtë Marrëveshje Financiare do të gëzojnë mbrojtjen e tij dhe do t'u jepen lejë kalimi të nevojshme për të bërë të mundur

lëvizjen e lirë të tyre brenda territorit të Shqipërisë;

- të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e Programit dhe anëtarëve të afërt të familjeve të tyre do t'u akordohen përfitime jo më pak të favorshme, privilegje dhe përjashtime si ato që zakonisht i akordohen të punësuarve të tjerë të stafit ndërkombëtar në Shqipëri, sipas çdo marrëveshjeje dypalëshe ose shumëpalëshe për ndihmë ekonomike;

- të gjithë personelit që merr pjesë në zbatimin e Programit dhe anëtarëve të afërt të familjeve të tyre t'u lejohet hyrja në Shqipëri për t'u vendosur për të punuar dhe për t'u larguar nga Shqipëria ashtu siç parashikohet në kontratë;

- do të jepen të gjitha lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve për këtë Program, si dhe lejet e kërkuara për rieksporimin e po të njëjtëve artikuj;

- të gjitha importet e kryera nën këtë Marrëveshje Financiare do të përjashtohen nga taksat e doganave, detyrimet eksportuese ose taksa dhe ngarkesa të tjera fiskale;

- të gjitha prokurimet publike të pajisjeve dhe shërbimeve të zhvilluara nën këtë Marrëveshje Financiare do të përjashtohen nga taksat e shitjeve ose tarifave të tjera fiskale të së njëjtës natyrë;

- në të gjitha këto raste, Përfituesi do të sigurojë bashkëpunim të plotë me autoritetet përkatëse;

- përveç të tjerash, Përfituesi do të sigurojë akses në kompanitë shtetërore dhe institucione të tjera qeverisëse, të cilat do të përfshihen ose janë të nevojshme për zbatimin e Programit.

Në rast vështirësish në zbatimin e Programit, Palët bien dakord të konsultohen menjëherë, me qëllim që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të zgjidhur këto vështirësi.

Importi dhe riekporti i pajisjeve

Përfituesi duhet të japë lejet e nevojshme për importimin e pajisjeve profesionale të kërkuara për të ekzekutuar masat që i nënshtrohen ligjeve ekzistuese, rregullave dhe rregulloreve të marrësit.

Përfituesi duhet t'u japë personave fizikë dhe juridikë që kanë ofruar punime, pajisje ose kontrata shërbimesh, lejet e kërkuara për rieksporimin e pajisjeve në fjalë.

#### Neni 9

#### **Hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare**

Marrëveshja Financiare do të hyjë në fuqi në datën në të cilën ajo do të nënshkruhet nga pala e fundit.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze, një kopje për Komisionin dhe një kopje për Përfituesin.

Për Komisionin:

Z.D.Meganeck

Drejtor

Bruksel

Data

Për Përfituesin:

Znj.Arenca Trashani

Ministre e Integrimit European

Tiranë

Data

Deklaratë: Për sa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi për Palën Shqiptare në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

**MINISTRE E INTEGRIMIT  
Arenca Trashani**

SHTOJCA I  
KUSHTET E PËRGJITHSHME

TITULLI I  
FINANCIMI I PROJEKTIT/PROGRAMIT

Neni 1  
**Parime të përgjithshme**

1.1 Kontributi financiar i Komunitetit do të kufizohet nga shuma e përcaktuar në Marrëveshjen Financiare.

1.2 Dhënia e financimit nga Komuniteti do të kushtëzohet nga plotësimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Financiare nga ana e Përfituesit.

Neni 2  
**Tejkalimi i kostove dhe mbulimi i tyre**

2.1 Tejkalimet individuale të zërave të buxhetit të Marrëveshjes Financiare do të trajtohen me anë të rishpërndarjes së fondeve të buxhetit të përgjithshëm, në përputhje me nenin 17 të këtyre kushteve të përgjithshme.

2.2 Në qoftë se ekziston një rrezik i tejkalimit të shumës totale të përcaktuar në Marrëveshjen Financiare, Komisioni mund të shkurtojë Projektin/Programin ose të kërkojë angazhimin e burimeve financiare të Përfituesit apo burime të tjera jokomunitare.

2.3 Në qoftë se Projekti/Programi nuk mund të shkurohet ose në qoftë se tejkalimi nuk mund të mbulohet as nga fondet e Përfituesit apo burime të tjera, Komisioni mund të japë përjashtimisht financime komunitare shtesë. Në këtë rast, kostot shtesë do të financohen pa cenuar rregullat dhe procedurat e Komunitetit, duke çelur një kontribut financiar shtesë, i cili do të përcaktohet nga Komisioni.

TITULLI II  
ZBATIMI

Neni 3  
**Parime të përgjithshme**

3.1 Projekti/Programi do të zbatohet nga Komisioni duke vepruar për dhe në emër të Përfituesit.

3.2 Komisioni do të përfaqësohet në shtetin e përfituesit nga kryetari i delegacionit të tij.

Neni 4  
**Periudhat e ekzekutimit**

4.1 Periudha e ekzekutimit të Marrëveshjes Financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe do të përfundojë në datën e përcaktuar në nenin 4 të kushteve specifike.

4.2 Kjo periudhë ekzekutimi do të përfshijë dy faza:

- një fazë operative zbatimi, ku kryhen veprimtaritë kryesore. Kjo fazë do të fillojë me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes Financiare dhe do të përfundojë 24 muaj përpara fundit të kohës së ekzekutimit.

- faza e mbylljes, gjatë së cilës do të kryhen kontrollet financiare dhe vlerësimi, si dhe do të mbyllet teknikisht dhe financiarisht kontratat për zbatimin e Marrëveshjes Financiare. Kjo fazë do të fillojë në datën e përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe do të përfundojë e shumta 24 muaj pas kësaj date.

4.3 Kostot që rrjedhin nga aktivitetet kryesore do të jenë të pranueshme për financimin e Komunitetit vetëm në qoftë se ato kanë lindur gjatë fazës operative të zbatimit. Kostot që rrjedhin nga

kontrolli financiar përfundimtar, vlerësimi dhe mbyllja e aktiviteteve do të jenë të pranueshme deri në fund të fazës së mbylljes.

4.4 Çdo fond i mbetur nga kontributi i Komunitetit do të fshihet automatikisht gjashtë muaj pas përfundimit të periudhës së ekzekutimit.

4.5 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e fazës operative të zbatimit dhe rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës operative të zbatimit dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

4.6 Në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara siç duhet dhe pas përfundimit të fazës operative të zbatimit, mund të paraqitet një kërkesë për zgjatjen e afatit të fazës së mbylljes dhe rrjedhimisht, të periudhës së ekzekutimit. Në qoftë se zgjatja e afatit kërkohet nga Përfituesi, kërkesa duhet të paraqitet të paktën tre muaj përpara përfundimit të fazës së mbylljes dhe të miratohet nga Komisioni përpara kësaj date.

### TITULLI III LIDHJA E KONTRATAVE DHE DHËNIA E GRANDEVE

#### Neni 5 **Parime të përgjithshme**

Të gjitha kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare duhet të lidhen në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për zbatimin e operacioneve të jashtme në fuqi në momentin e nisjes së procedurave në fjalë.

#### Neni 6 **Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave të zbatimit të Marrëveshjes Financiare**

6.1 Kontratat e zbatimit të Marrëveshjes Financiare duhet të nënshkruhen nga të dyja palët brenda tre vjetësh nga miratimi i angazhimit buxhetor nga Komisioni, pra maksimumi deri në datën e caktuar në nenin 5 të kushteve specifike. Ky afat nuk mund të shtyhet.

6.2 Norma e mësipërme nuk do të zbatohet për kontratat e kontrollit financiar dhe të vlerësimit, të cilat mund të nënshkruhen edhe më vonë.

6.3 Në datën e përmendur në nenin 5 të kushteve specifike, çdo fond për të cilin nuk është nënshkruar ndonjë kontratë, do të anulohet.

6.4 Çdo kontratë, për të cilën nuk ka filluar asnjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj, do të përfundojë automatikisht dhe fondet e saj do të anulohen.

#### Neni 7 **Pranueshmëria**

7.1 Pjesëmarrja në ftesat për tendera për kontratat për punime, furnizime ose shërbime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve rregulluese bazë të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese, ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.2 Pjesëmarrja në konkurset për propozime është e hapur në kushte të barabarta për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të shteteve anëtare të Komunitetit dhe në përputhje me kushtet specifike të akteve rregulluese bazë të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të vendeve të treta përfituese ose të çdo vendi tjetër të tretë të përcaktuar shprehimisht në këto akte.

7.3 Në mënyrë të jashtëzakonshme, në raste të justifikuara të miratuara nga Komisioni, mund të vendoset që në bazën e kushteve specifike të përcaktuara në aktet rregulluese bazë të sektorëve të interesuar të bashkëpunimit, të lejohen shtetasit e vendeve të treta, të ndryshëm nga ana të përcaktuar në

paragrafët 1 dhe 2, të marrin pjesë në tenderat për kontrata.

7.4 Mallrat dhe furnizimet e financuara nga Komuniteti dhe të nevojshme për përmbushjen e kontratave të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve, si dhe të procedurave të prokurimit të nisura nga përfituesi i grantit për ekzekutimin e aktivitetit të financiar, duhet ta kenë origjinën e tyre në vende të pranueshme për të marrë pjesë siç përcaktohet në tre paragrafët e mësipërm.

7.5 Ky rregull i kombësisë do të zbatohet gjithashtu për ekspertët e propozuar nga ofruesit e shërbimeve, të cilët do të marrin pjesë në procedurat e tenderave ose në kontratat e shërbimeve të financuara nga Komuniteti.

#### TITULLI 4 RREGULLAT E ZBATUESHME PËR PËRMBUSHJEN E KONTRATAVE

##### Neni 8

##### **E drejta e vendosjes dhe e qëndrimit**

8.1 Kur justifikohet nga natyra e kontratës, personat fizikë dhe juridikë që marrin pjesë në ftesat për tenderat për kontratat e punimeve, furnizimeve ose shërbimeve do të gëzojnë të drejtën e përkohshme të vendosjes dhe të qëndrimit në vendin e Përfituesit. Kjo e drejtë do të jetë e vlefshme për një muaj pas dhënies së kontratës.

8.2 Kontraktuesit (duke përfshirë përfituesin e grantit) dhe personat fizikë, shërbimet e të cilëve janë të nevojshme për përmbushjen e kontratave, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të gëzojnë të drejta të ngjashme gjatë zbatimit të Projektit/Programit.

##### Neni 9

##### **Normat tatimore dhe doganore**

9.1 Përveç rasteve ku parashikohet në kushtet specifike, detyrimet doganore dhe detyrime të tjera (duke përfshirë TVSH-në ose taksa ekuivalente) do të jenë të përjashtuara nga financimi i Komunitetit.

9.2 Shteti përfitues duhet të aplikojë për kontratat e prokurimeve dhe grantet e financuara nga Komuniteti, normat tatimore dhe doganore më të favorizuara, të aplikuara për shtetet ose organizatat e zhvillimit ndërkombëtar me të cilat ai ka marrëdhënie.

9.3 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të zbatohen gjithashtu.

##### Neni 10

##### **Normat mbi kursin e këmbimit**

10.1 Shteti Përfitues merr përsipër të autorizojë importin ose blerjen e valutës së huaj të nevojshme për zbatimin e Projektit. Ai merr përsipër gjithashtu të aplikojë normativën e tij kombëtare për këmbimin e valutës në një mënyrë jo diskriminuese për kontraktuesit që lejohen të marrin pjesë sipas nenit 7 të këtyre kushteve.

10.2 Aty ku Marrëveshja kuadër ose shkëmbimi i letrave të aplikueshme përfshin norma më të detajuara mbi këtë çështje, ato duhet të aplikohen gjithashtu.

##### Neni 11

##### **Përdorimi i të dhënave nga studimet**

Aty ku Marrëveshja Financiare përfshin financimin e një studimi, kontrata në lidhje me këtë studim, nënshkruar për zbatimin e Marrëveshjes Financiare, duhet të rregullojë pronësinë e këtij studimi, si dhe të drejtat e Përfituesit ose të Komisionit për të përdorur të dhënat në studim, për ta publikuar atë

ose për t'jua dhënë palëve të treta.

#### Neni 12

### **Alokimi i fondeve të rikthyera nga kontratat**

12.1 Fondet e rikthyera nga pagesat e kryera gabimisht, nga garancitë e pagesave parafinancuese ose nga përfitimet që rrjedhin nga garancitë e ofruara në bazë të kontratave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, do të alokohen për Projektin/Programin.

12.2 Gjobat financiare të vendosura nga autoriteti kontraktues ndaj një kandidati apo pjesëmarrësi në tender, i cili hyn në rastet e përjashtimit në kuadrin e një kontrate prokurimi, kërkesa për garancitë e tenderit, si dhe dëmet që i shkaktohen Komisionit, do t'i ripaguhen buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

#### TITULLI 5

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE**

#### Neni 13

### **Transparenca**

13.1 Çdo projekt/program i financuar nga Komuniteti do të jetë objekt i operacioneve të përshtatshme informuese dhe komunikuese. Këto veprime do të përcaktohen me miratimin e Komisionit.

13.2 Këto operacione informuese dhe komunikuese duhet të kryhen sipas rregullave të përcaktuara e të publikuara nga Komisioni për transparencën e aktiviteteve të jashtme në fuqi në momentin e kryerjes së këtyre veprimeve.

#### Neni 14

### **Parandalimi i parregullive, mashtrimit dhe korrupsionit**

14.1 Përfituesi duhet të marrë masat e përshtatshme për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimet dhe me kërkesë të Komisionit, të nisë ndjekjet penale për rikthimin e fondeve të paguara gabimisht. Përfituesi do të informojë Komisionin për çdo masë të marrë.

14.2 "Parregullsi" do të thotë çdo shkelje e Marrëveshjes Financiare, kontratave të zbatimit ose të së drejtës komunitare, i cili shkaktohet si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të një operatori ekonomik dhe që ka ose do të kishte si efekt cenimin e buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane ose të buxheteve të administruara prej tyre, duke pakësuar ose duke humbur të ardhura që rrjedhin nga burime të tyre të mbledhura në mënyrë të drejtpërdrejtë në emër të Komuniteteve Europiane ose nga çdo zë i pajustificuar shpenzimi.

"Mashtrim" do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm, që lidhet me:

- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve apo deklaratave të rreme, jo korrekte ose të paplota, të cilat kanë si efekt të tyre përvetësimin ose mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane ose nga buxhetet e administruara prej tyre apo në emër të tyre;

- mosdhënien e informacionit në kundërshtim me detyrimet specifike, me të njëjtin efekt;

- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat janë ofruar fillimisht.

Përfituesi do të informojë menjëherë Komisionin për çdo element që sillet në vëmendjen e tij, i cili lë për të dyshuar për parregullsi ose mashtrim.

14.3 Përfituesi merr përsipër të ndërmarë të gjitha masat e duhura për të ndrequr çdo praktikë korruptive, pasive ose aktive, çfarëdo qoftë ajo, në çdo fazë të procedurës për dhënien e kontratave ose grandeve apo në zbatimin e kontratave që lidhen me të. "Korrupsion pasiv" do të thotë veprim i paramenduar i një nëpunësi, i cili, direkt ose me anë të një ndërmjetësi, kërkon ose përfiton avantazhe të çdo lloji, çfarëdo qoftë ky, për veten e tij ose për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, për të vepruar ose për t'u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij apo në



ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane. “Korrupsion aktiv” do të thotë veprim i paramenduar i cilitdo që, direkt apo nëpërmjet një ndërmjetësi, i premtos ose i jep një avantazh të çdo lloji, çfarëdo qoftë ai, një nëpunësi për veten e tij ose për një palë të tretë, për të vepruar ose për t’u shmangur nga veprimi në përputhje me detyrën e tij ose në ushtrimin e funksioneve të tij, duke shkelur detyrat e tij funksionale, veprim që ka ose do të kishte si efekt cenimin e interesave financiare të Komuniteteve Europiane.

#### Neni 15

### **Verifikimet dhe kontrollet nga Komisioni, Zyra Europiane kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane**

15.1 Përfituesi bie dakord që Komisioni, OLAF-i dhe Gjykata e Kontrollit Financiar e Komuniteteve Europiane të kryejnë kontrolle dokumentacioni apo në vend mbi përdorimin që i është bërë financimit të Komunitetit sipas Marrëveshjes Financiare (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave dhe grandeve), si dhe të kryejnë një kontroll financiar të plotë, nëse është e nevojshme, në bazë të dokumenteve mbështetëse të llogarive dhe dokumenteve kontabël si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me financimin e Projekt/Programit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes, si dhe për shtatë vjet pas datës së pagesës së fundit.

15.2 Përfituesi bie dakord gjithashtu që OLAF-i mund të kryejë kontrolle në vend dhe verifikime në përputhje me procedurat e përcaktuara nga e drejta komunitare për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Europiane kundër mashtrimit dhe parregullive të tjera.

15.3 Për këtë qëllim, Përfituesi merr përsipër t’u japë nëpunësve të Komisionit, të OLAF-it dhe të Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane, si dhe përfaqësuesve të tjerë të autorizuar, mundësinë e hyrjes në vendet dhe ambientet në të cilat janë kryer aktivitetet e financuara sipas Marrëveshjes Financiare, duke përfshirë sistemet kompjuterike, si dhe çdo dokument ose të dhënë të informatizuar që lidhet me administrimin teknik dhe financiar të këtyre aktiviteteve, si dhe të marrë përsipër çdo masë që është e nevojshme për të lehtësuar punën e tyre. Kjo mundësi hyrjeje për përfaqësuesit e autorizuar të Komisionit Europian, të OLAF-it dhe Gjykatës së Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane do të jepet në kushtet e një konfidencialiteti të plotë lidhur me palët e treta, duke mos cenuar detyrimet që rrjedhin nga e drejta publike të cilave ato i nënshtrohen. Dokumentet duhet të jenë të konsultueshme dhe të arkivuara në një mënyrë që të lejojë inspektim të lehtë të tyre. Përfituesi është i detyruar të njoftojnë Komisionin, OLAF-in ose Gjykatën e Kontrollit Financiar të Komuniteteve Europiane për vendin e saktë ku ruhen këto dokumente.

15.4 Kontrollet dhe kontrollet financiare të përmendura më sipër do të aplikohen edhe për kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, të cilët kanë përfituar financime të Komunitetit.

15.5 Përfituesi do të njoftohet mbi misionet e kontrollit në vend nga përfaqësuesit e emëruar nga Komisioni, OLAF-i ose Gjykata e Audituesve.

#### Neni 16

### **Konsultimet midis Komisionit dhe Përfituesit**

16.1 Përfituesi dhe Komisioni do të konsultohen me njëri-tjetrin përpara paraqitjes së çdo mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare.

16.2 Konsultimet mund të çojnë në ndryshimin, ndërprerjen ose përfundimin e Marrëveshjes Financiare.

#### Neni 17

### **Ndryshimet në Marrëveshjen Financiare**

17.1 Çdo ndryshim në kushtet specifike dhe shtojcën II të Marrëveshjes Financiare do të bëhet me shkrim dhe do të jetë objekt i një shtojce.

17.2 Në qoftë se kërkesa për ndryshim vjen nga Përfituesi, ky i fundit duhet t’ia paraqesë kërkesën Komisionit të paktën tre muaj përpara datës së propozuar për hyrjen në fuqi të shtojcës, me përjashtim të rasteve të justifikuara siç duhet nga Përfituesi dhe të pranuar nga Komisioni.

17.3 Rastet specifike të zgjatjes së afatit të fazës operative të zbatimit ose fazës së mbylljes janë

të rregulluara nga neni 4 (5) dhe (6) i këtyre kushteve të përgjithshme.

#### Neni 18

##### **Pezullimi i Marrëveshjes Financiare**

18.1 Marrëveshja Financiare mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) Komisioni mund të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes Financiare në qoftë se Përfituesi shkel detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja Financiare.

b) Komisioni mund të pezullojë Marrëveshjen Financiare në qoftë se Përfituesi shkel një detyrim që lidhet me të drejtat e njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës dhe në rastet serioze të korrupsionit.

c) Marrëveshja Financiare mund të pezullohet për shkak të një force madhore siç përcaktohet më poshtë. “Forcë madhore” do të thotë një situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon palët në përmbushjen e çdo detyrimi dhe që nuk mund t’i ngarkohet një gabimi ose pakujdesie të tyre (ose kontraktuesve të tyre, përfaqësuesve ose punonjësve), si dhe provohet të jetë e pakapërcyeshme pavarësisht nga përpjekjet që mund të bëhen defekt në pajisje ose materiale apo vonesat për t’i bërë të disponueshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të konsiderohen si forcë madhore. Një palë nuk do të konsiderohet në shkëlqje të detyrimeve të saj në qoftë se nuk ka mundur t’i përmbushë ato për shkak të një force madhore. Një palë që ballafaqohet me një forcë madhore duhet të informojë pa vonesë palën tjetër, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikuara të problemit. Gjithashtu ajo duhet të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

18.2 Asnjë njoftim paraprak nuk do të jepet për vendimin e pezullimit.

18.3 Në momentin e njoftimit të pezullimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t’u nënshkruar.

#### Neni 19

##### **Përfundimi i Marrëveshjes Financiare**

19.1 Në qoftë se çështjet që shkaktojnë pezullimin e Marrëveshjes Financiare nuk zgjidhen për një periudhë katërmujore, çdo palë mund të mbarojnë Marrëveshjen Financiare në dy muaj paralajmërim.

19.2 Kur një marrëveshje financiare nuk ka filluar ndonjë pagesë brenda tre vjetësh nga nënshkrimi i saj ose kontratat e zbatimit nuk janë nënshkruar sipas datave të përcaktuara në nenin 5 të këtyre kushteve, atëherë marrëveshja financiare do të mbarojë automatikisht.

19.3 Në momentin e njoftimit të mbarimit, do të tregohen edhe pasojat mbi kontratat në fuqi ose kontratat që janë ende për t’u nënshkruar.

#### Neni 20

##### **Rregullime për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve**

20.1 Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen Financiare, e cila nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve sipas nenit 16 të këtyre kushteve, mund të zgjidhet me anën e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve.

20.2 Në këtë rast, secila nga palët do të caktojë një gjyqtar arbitrazhi brenda 30 ditësh nga paraqitja e kërkesës për arbitrazh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t’i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një gjyqtar arbitrazhi të dytë. Nga ana e tyre, dy gjykatësit e arbitrazhit do të caktojnë një gjyqtar të tretë arbitrazhi brenda 30 ditësh. Në qoftë se kjo nuk verifikohet, secila nga palët mund t’i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë gjyqtarin e tretë të arbitrazhit.

20.3 Përveç rastit kur gjyqtarët e arbitrazhit vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e përcaktuara në Rregullat Fakultative të Arbitrimit për Organizatat Ndërkombëtare dhe Shtetet e Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit. Vendimi i gjyqtarëve të arbitrazhit do të merret me shumicë votash brenda një periudhe tremujore.

20.4 Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të gjyqtarëve të arbitrazhit.

Rezervë. Për sa i përket nenit 9, kjo Marrëveshje Financiare do të hyjë në fuqi për Palën Shqiptare në ditën e hyrjes në fuqi të ligjit për ratifikimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë.

MINISTRE E INTEGRIMIT EUROPIAN  
Arenca Trashani

SHTOJCË II  
DISPOZITAT TEKNIKE DHE ADMINISTRATIVE

Zyra e Asistencës Doganore dhe Fiskale (CAFAO) për vendet e Ballkanit Perëndimor  
Programi rajonal 2006

1. Identifikimi

Zëri në buxhet	22 05 01 (Asistencë për vendet e Ballkanit Perëndimor) 22 05 02 (Asistencë për Serbinë dhe Malin e Zi) 22 05 03 (Ndihmë për rindërtimin e Kosovës)
Kosto totale	14 000 000 euro
Baza ligjore	Rregullorja e Këshillit 2666/2000
Vendet Përfituese	Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina (BiH), Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Serbia dhe Mali i Zi, duke përfshirë Republikën e Serbisë, Republikën e Malit të Zi dhe Kosovën (siç është përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10.6.1999)
Viti buxhetor	2006
Kontraktimi	Të gjitha kontratat duhet të mbyllet pas nënshkrimit të Marrëveshjes Financiare dhe brenda 36 muajve pas datës së angazhimit buxhetor.
Zbatimi	Data përfundimtare e zbatimit të projekteve nën këtë propozim është 31.12.2014. Për këtë arsye, të gjitha aktivitetet, duke përfshirë kontratat, pagesat, monitorimin, auditin dhe vlerësimin duhet të përfundojnë brenda kësaj date.
Zbatimi	Menaxhim i centralizuar

2. Situata në rajon

Për të mbështetur përpjekjet për të rritur të ardhurat e shtetit, luftën kundër krimit të organizuar, krijimin e një administrate të aftë dhe të përgjegjshme, si dhe për të ndërtuar marrëdhënie të mira tregtare si në rajonin e Ballkanit Perëndimor<sup>1</sup>, ashtu edhe me vendet anëtare të BE-së dhe pjesën tjetër të botës, krijimi i sistemeve mirëfunksionuese të tatimeve dhe doganave në vendet e Ballkanit Perëndimor është kritike. E rëndësishme është gjithashtu edhe për procesin e Stabilizim-Asociimit, si dhe për formimin e një marrëdhënieje kontraktuale me BE-në, duke nënshkruar një marrëveshje Stabilizim-Asociimi.

Një gjurmim i kënaqshëm i të dhënave të një vendi në zbatimin e detyrimeve të MSA-së do të jetë një element thelbësor për BE-në, kur ajo të konsiderojë çdo aplikim për anëtarësim. Deri tani, nga vendet e sipërpërmendura, vetëm FYROM dhe Kroacia kanë një MSA në fuqi. Diskutimet me Bosnjë-Hercegovinën janë hapur në dhjetor 2005.

Bashkimi Europian ndërmori programin e tij CAFAO në 1996 për të bërë të mundur krijimin e shërbimeve doganore në Bosnjë-Hercegovinë. Më specifikisht, programi CAFAO është ngarkuar të asistojë vendin në zbatimin e dispozitave në lidhje me doganat e Kuadrit të Përgjithshëm të Marrëveshjes për Paqe të Dejtonit të vitit 1995.

Programi CAFAO është zgjeruar më tej për të përfshirë asistencë teknike në mbledhjen e

<sup>1</sup> Vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina (BiH), Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), Serbia dhe Mali i Zi, duke përfshirë Republikën e Serbisë, Republikën e Malit të Zi dhe Kosovën (siç është përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10.6.1999).

tatimeve indirekte, si p.sh. taksat e shitjeve dhe detyrimet e akcizës, duke ndjekur konkluzionet e Këshillit të Zbatimit të Paqes në Bon në dhjetor 1997. Në një këndvështrim më të gjerë, program CAFAO ka eksperiencë në aspektet e aktivitetit të doganave dhe në administrata të ndryshme fiskale në Shqipëri (CAM-A), Kosovë (CAFAO-UNMIK), ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (CAFAO-MAK) dhe Serbinë e Malin e Zi (CAFAO Serbia dhe CAFAO-Mali i Zi). Kroacia nuk është pjesë e programit CAFAO.<sup>2</sup>

Në përgjithësi, shërbimet vendase doganore me programet e tyre përkatëse CAFAO kanë adresuar nevojat e tyre drejt krijimit të një shërbimi efikas doganor, i cili jo vetëm lejon një menaxhim më të mirë të pikave të kalimit të kufirit dhe atyre të kontrolleve doganore në aeroporte dhe/ose porte për sigurinë publike, por gjithashtu rrit peshën e të ardhurave nga detyrimet doganore dhe akcizat në një treti të ligjshme. Nga kjo rritje e të ardhurave, qeveritë vendase mund të rrisin shpenzimet publike, p.sh. zhvillimin social. Gjithashtu mund të zhvillojnë infrastrukturën e nevojshme, e cila jo vetëm siguron efektivitetin në luftën kundër krimit të organizuar dhe mashtrimit tregtar, por lehtëson edhe tregtinë e ligjshme.

Gjendja ekzistuese e infrastrukturës vendase si për administratën doganore dhe atë të tatimeve indirekte ka ndikuar në shtrirjen e aktivitetit të programit CAFAO në çdo vend. Për shembull, në Republikën e Malit të Zi, i cili filloi procesin e tij kalimtar nga taksa mbi shitjen në një sistem takse të vlerës së shtuar në linjë me atë të BE-së në 2000, CAFAO kryesisht ka fokusuar përpjekjet e tij në sigurimin që sistemi të mbetet i përqasur me atë të BE-së. Në Bosnjë-Hercegovinë CAFAO ka qenë tërësisht i përfshirë për disa vjet, në përgatitjen e rrugës që duhet të ndjekë vendi për të kaluar në një sistem TVSH si ai i BE-së në vitin 2006.

Me qëllim sigurimin e një përqasjeje koherente në përmirësimin e shërbimit të taksave dhe doganave në vendet e Ballkanit Perëndimor, programi CAFAO, përdor si rregull orientimin e planeve të BE-së për fushën e doganave dhe taksave, i cili është përgatitur nga KE-ja si një model për zhvillimin e punës. Kjo ndihmon në garantimin që puna e realizuar nga ky program të jetë në linjë me standardet e BE-së dhe të kontribuojë në PSA në të gjithë rajonin si një e tërë. Programi CAFAO vepron nëpërmjet ekipeve të ekspertëve të BE-së në vende të cilat tashmë plotësojnë punën e bërë nga ekspertët vendas. Menaxhimi i përditshëm i programit CAFAO mbikëqyret nga KE-ja.

### 3. Përmbledhje e programit të veprimit

Objektivi i përgjithshëm i programit të veprimit vjetor 2006 është të vazhdojë të asistojë autoritetet e doganave dhe tatimeve të vendeve përfituese në përgatitjen e tyre drejt anëtarësimit të ardhshëm në BE. Programi CAFAO ka treguar që është i suksesshëm, veçanërisht në zhvillimin e kapaciteteve të vendeve të Ballkanit për të menaxhuar kufijtë, si dhe për të rritur të ardhurat nga detyrimet doganore dhe të akcizës. Është thelbësore që ky program të vazhdojë të mbajë këtë nivel të lartë të dhënies së shërbimeve dhe të sigurojë që asistencat teknike të jepet sipas prioriteteve të përcaktuara nga Partneritetet Europiane të Komisionit, raportet e progresit 2005, si dhe dialogu i vazhdueshëm me autoritetet kombëtare.

Rezultate të cilat synohen të arrihen në të gjitha vendet përfituese janë:

- Zhvillimi i kapaciteteve administrative të përfituesve;
- Arritja e qëndrueshmërisë, transferimit të dijeve dhe pronësisë *in fine* nga përfituesi; dhe
- Përgatitja për një strategji dalëse.

Rezultate të përbashkëta që synohen të arrihen në të gjitha vendet përfituese janë:

- Legjislacioni dhe procedurat e doganave do të vazhdojnë të përafrohen me ato të BE-së, ndërsa do të arrihet një zbatim i plotë dhe i qëndrueshëm përgjatë gjithë territorit. Vëmendje e veçantë do të duhet t'i kushtohet rregullave të origjinës dhe bashkëpunimit administrativ.

- Legjislacioni indirekt i tatimeve do të përafrohet më tej me atë të BE-së. Gjithashtu, nevojitet të arrihet progres në tatimet direkte, veçanërisht me zbatimin e Kodit të Sjelljes të Tatimit të Bizneseve. Kapacitetet administrative për të zbatuar legjislacionin e doganave dhe për të luftuar korrupsionin dhe krimin ndërkufitar do të jetë forcuar. Do të përdoren gjithashtu planet e BE-së për doganat.

- Kapacitetet administrative të administratës tatimore, duke përfshirë kapacitetet mbledhëse dhe kontrolluese do të jenë forcuar më tej dhe lufta kundër korrupsionit dhe mashtrimit të taksave do të jetë

---

<sup>2</sup> Misionet CAFAO janë ngritur në mënyrë progresive në vite, duke u bazuar në nevojat për rindërtim të doganave dhe tatimeve në vendet përkatëse. Nuk është konsideruar e nevojshme për të pasur këtë formë asistence në Kroaci për shkak se sapo ka filluar PSA është nënshkruar MSA në maj 1999.

bërë me efikase. Do të zhvillohet një strategji kombëtare kontrolli. Do të përdoren gjithashtu planet e BE-së për doganat.

- Transparenca dhe shkëmbimi i informacionit me vendet anëtare të BE-së do të jetë përmirësuar, me qëllim lehtësimin e zbatueshmërisë së masave parandaluese të evazionit fiskal.

- Procesi i kompjuterizimit të administratës së taksave dhe doganave do të ketë filluar dhe arritur progres.

Rezultate specifike shtesë, të cilat synohen të arrihen janë si më poshtë:

Shqipëria:

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë për të zbatuar sistemin e deklarimit të doganave dhe procedimit ASYCUDA në të gjitha zyrat doganore.

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë për të zbatuar rregullat e vlerësimit doganor në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.

Bosnjë-Hercegovina:

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë me qëllim sigurimin e një kuadri ligjor për zonat e lira, në përputhje me standardet e BE-së dhe të garantohet mbikëqyrja e tyre e mjaftueshme.

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë për të zbatuar rregullat e vlerësimit doganor në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.

- Autoriteti i tatimeve indirekte do të forcohet më tej.

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë për të zbatuar dhe bërë të detyrueshëm ligjin për TVSH-në dhe për të ngritur infrastrukturën ligjore dhe administrative të kërkuar për zbatimin e tij.

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë:

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë për të përafuar nivelin e taksës së doganimit me atë të BE-së.

- Përfituesi do të ketë marrë asistencë për të amenduar regjimin e tatimeve për prodhimet e duhanit me qëllim që t'i jepet fund diskriminimit ekzistues midis prodhimeve të brendshme dhe atyre të importuara.

- Do të kenë filluar përgatitjet për ndërlikohen e sistemeve kombëtare të teknologjisë së informacionit me ato të BE-së në fushën e doganave dhe tatimeve.

Serbia dhe Mali i Zi:

- (Serbia) Zbatimi i sistemit kombëtar të menaxhimit të integruar të tarifave (TARIS) do të ecë përpara në përputhje me modelin e BE-së.

- (Mali i Zi) Objektivat e përbashkëta të identifikuar më lart reflektojnë prioritetet për Malin e Zi.

Kosova:

- Kapacitetet e njësisë për hetime kriminale do të jenë forcuar.

4. Zbatimi

Programi CAFAO do të zbatohet në mënyrë të centralizuar.<sup>3</sup> Komisioni ka nënshkruar një kontratë me Eurocustoms për dhënien e asistencës teknike në fushën e doganave dhe tatimeve në Ballkanin Perëndimor. Faza fillestare e kontratës (9 muaj) është financuar nga fondet e mbetura të vendimeve CARDS të viteve të mëparshme në sektorin e tatimeve dhe doganave. Eurocustoms do të vazhdojë të sigurojë asistencë teknike për autoritetet përfituese nëpërmjet zbatimit të programeve të punës vjetore të cilat do të përgatiten, miratohen dhe monitorohen në koordinim të ngushtë me përfituesit dhe Komisionin.

Në mënyrë që të arrihen objektivat e përmendura në pikën 3 më lart, Eurocustoms:

- do të sigurojë asistencë teknike për autoritetet e doganave dhe tatimeve të vendeve përfituese në

---

<sup>3</sup> Programi do të zbatohet në mënyrë të centralizuar direkt sipas nenit 53.1(a) të rregullores së Këshillit (EC, Euroatom) nr.1605/2002 të datës 25.6.2002 mbi Rregulloren financiare të aplikuar në buxhetin e përgjithshëm të Komisionit Europian, siç është detajuar më tej në rregullat e zbatimit të rregullores së Këshillit mbi Rregulloren Financiare të buxhetit të përgjithshëm të KE-së.

hartimin e legjislacionit dhe rregullave të zbatimit në fushat në fjalë;

- do të asistojë vendet të vendosin struktura efikase administrative, si dhe procedura të drejta zbatimi dhe kontrolli për të zhvilluar, zbatuar dhe bërë të detyrueshëm legjislacionin përkatës;

- do të transferojë njohuritë e duhura autoriteteve përfituese nëpërmjet programeve të trajnimit, me fokus të veçantë në programet për trajnimin e trajnerëve;

- do të asistojë vendet në zhvillimin e bashkëpunimit me autoritetet kompetente të vendeve të BE-së dhe vendeve fqinje, si dhe në vendosjen e partneriteteve me institucionet e duhura dhe të kualifikuara (administratat, shërbimet, laboratorët etj.) në vendet e BE-së;

- do të lehtësojë në të gjitha mënyrat pronësinë përfundimtare nga ana e përfituesit dhe përgatitet për një strategji dalëse.

Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve do të bazohet në progresin në arritjet e rezultateve të pritshme, siç është parashtruar edhe në programet e punës. Progresi do të rishikohet rregullisht nëpërmjet raporteve mujore dhe tremujore të aktiviteteve.

5. Asistenca e kaluar e KE-së dhe mësimet e nxjerra

- Asistenca e kaluar e Komisionit European

Programi i CAFAO/Viti	Alokuar (euro)	Kontraktuar (euro) *	Paguar (euro)
CAFAO 2003 *	27 000 000	25. 187. 417. (93.3%)	20562641 (81.6%)
CAFAO 2004 *	17 500 000	11. 947. 455 (68.35%)	6073456 (37.7%)
CAFAO 2005 *	14 500 000	2. 818. 131 (19.4%)	142.049 (10%)

\*shifrat i përkasin periudhës deri në 10 nëntor 2005

Që nga krijimi i programit CAFAO në 1996, asistenca është dhënë dhe menaxhuar në nivel vendi. Zbatimi i programit të veprimit 2006 do të rajonalizohet.

Mësime të nxjerra

- Programi do të përfitojë nga mësimet e nxjerra nga pjesë të tjera të rajonit të Ballkanit, ku projektet e CAFAO-s janë në fazën e zbatimit. Do të shfrytëzohet mundësia për të zbatuar elemente të ndryshme të projekteve duke përdorur të njëjtën përjasje procedurale dhe instrumentet e zbatimit, me qëllim që të sigurohet një përjasje e qëndrueshme dhe kohezive në rajon.

- Rëndësia e tatimeve, duke pasur parasysh efektet e marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe anëtarësisë në OBT, ka ardhur gjithmonë në rritje, kështu që fokusi i programit do të kalojë progresivisht nga doganat tek tatimet.

- Mbështetje e vazhdueshme për të siguruar një progres të qëndrueshëm sidomos në zhvillimin e planeve vjetore operationale, të cilat janë në qendër të një përjasjeje strategjike.

6. Masa plotësuese

Shumë donatorë janë aktivë në rajon, por pak prej tyre kanë ndërmarrë hapa në fushën e tatimeve dhe doganave.

Shqipëria

Koordinimi i asistencës teknike të donatorëve për shërbimet e doganave zhvillohet nëpërmjet takimeve të Grupit të Punës të Menaxhimit të Kufirit dhe Krimit të Organizuar të Konsorciumit Ndërkombëtar të donatorëve në sektorin e policisë dhe sigurisë.

Mbretëria e Bashkuar, nëpërmjet konsultimeve private (PWC) ka siguruar mbështetje domethënëse për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (CAM-A (CAFAO në Shqipëri) ka mbajtur lidhje të ngushta me agjentët konsultues për të siguruar që dy programet të plotësojnë njëra-tjetrën dhe të shmangen duplikimet dhe mesazhet e përziera.

Bosnjë-Hercegovina

Programi CAFAO koordinohet në nivel pune me Misionin e Policisë së BE-së dhe Shërbimin Kufitar Shtetëror dhe mbështetet në ndihmën e tyre operationale për elementet e projektit, të cilët asistojnë autoritetet lokale për t'u përballuar me trafikun e paligjshëm.

Në fushën e ndërlikuar të menaxhimit të integruar të kufirit IBM, Komisioni European koordinohet me zyrën e Bankës Botërore dhe partnerët e saj zbatues në Bosnjë-Hercegovinë si dhe

Drejtorinë e Zbatimit të Projekteve në Ministrinë e Komunikimit dhe Transportit të Bosnjë-Hercegovinës. Qeveria e SHBA-së nëpërmjet ICITAP-it është aktive në fushën e IBM-së, veçanërisht nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe mbështetjes në rrjet të Shërbimit Kufitar Shtetëror. Asistenca teknike e SHBA-së plotëson ndërhyrjet nën programin CARDS, pa krijuar ndonjë mbivendosje.

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë

Programi CAFAO në fushën e doganave koordinohet me projektin e Bankës Botërore. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit në Europën Juglindore dhe me projektin dypalësh me Holandën. Në fushat e tatimeve dhe doganave, programi do të koordinohet me programin e mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve operacionale në të sapokrijuarën Polici Financiare, program i cili është duke u propozuar nga USAID-i.

Serbia, Mali i Zi dhe Kosova

Programi CAFAO në Serbi dhe Malin e Zi koordinohet nëpërmjet Agjencisë Europiane për Rindërtim, si dhe me donatorë të tjerë, si p.sh.: USAID, GTZ, Banka Botërore, PNUD dhe Ambasada Britanike. Për më tepër, kryetari i programit CAFAO në Serbi ka përgjegjësinë të bëjë të mundur që të tre programet CAFAO (në Serbi, Mal i Zi dhe Kosovë) të koordinohen plotësisht.

Në Kosovë program CAFAO koordinohet plotësisht me donatorë të tjerë (duke përfshirë USAID-in). Elemente të ndryshme të programit janë zhvilluar në konsultim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut dhe Drejtorinë e Përgjithshme në TAK, të mbështetur nga këshilltari i tij i USAID-it.

Përveç kësaj, kontakte të rregullta mbahen nga ekipi i CAFAO-s me projekte të ngjashme në fushën e menaxhimit të kufirit p.sh. projektet rajonale në fushën e IMB-së dhe drejtësisë dhe çështjeve të brendshme si në nivel kombëtar, ashtu edhe atë rajonal.

Ju lutem referojuni fishave të sektorit bashkëlidhur, për detaje të mëtejshme në lidhje me çdo vend.

#### 7. Koordinimi i donatorëve

Fishat e sektorit të vendeve individuale, të përfshira në shtojcë janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse të tatimeve dhe doganave të përfituesve. Koordinimi i donatorëve do të realizohet nga misionet e CAFAO-s dhe delegacionet e BE-së.

#### 8. Kostot dhe financimi

Një ndarje me tregues e buxhetit të programit të punës 2006 jepet më poshtë.

Vendi	Buxheti 2006 euro/milion
Shqipëria	2.0
Bosnjë-Hercegovina	5.0
Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	2.0
Kosova	2.5
Mali i Zi	1.5
Serbia	1.5
Totali:	14.0

Kosova ndodhet aktualisht nën Administratën e Kombeve të Bashkuar (UNMIK), por prezenca e kësaj të fundit pritet të ulet. Në këtë kontekst, ka të ngjarë që përgjegjësitë të transferohen nga doganat e UNMIK-ut tek institucionet e Kosovës, gjë e cila mund të çojë në nevojën për asistencë nga ana e CAFAO-s dhe që do të rezultojë në nevoja më të mëdha financiare. Buxheti i programit të veprimtimit 2007 mund të reflektojë këtë asistencë shtesë të kërkuar.

### LIGJ

Nr.9778, datë 16.7.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS TRIPALËSHE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË BULLGARISË DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR SISTEMIN E NAFTËSJELLËSIT TRANSBALLKANIK”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa tripalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë për sistemin e naftësjellësit transballkanik”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5421, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**KONVENTË TREPALËSHE**

NË LIDHJE ME SISTEMIN E NAFTËSJELLËSIT TRANSBALLKANIK NDËRMJET REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË BULLGARISË DHE REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

31 janar 2007

Kjo Konventë trepalëshe bëhet më 31 janar 2007 ndërmjet:

1. Republikës së Shqipërisë
2. Republikës së Bullgarisë dhe
3. Republikës së Maqedonisë.

HYRJE

A) Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë dhe Republika e Maqedonisë janë nënshkruese të Marrëveshjes për Kartën e Energjisë;

B) Shtetet duan të bashkëpunojnë në lehtësimin e zhvillimit, ndërtimit dhe operimit të naftësjellësit transballkanik për mbartjen e naftës në dhe përmes territoreve të tyre në pajtim me parimet e Memorandumit Trepalësh të Mirëkuptimit në lidhje me Projektin e nënshkruar nga shtetet më 28 dhjetor 2004; dhe

C) Shtetet tashmë duan të lidhin këtë Konventë për të parashikuar më shumë hollësi në lidhje me mirëkuptimin e arritur nga shtetet në këtë Memorandum trepalësh Mirëkuptimi, për të dhënë garanci dhe mbrojtje për investimet në Naftësjellësin Transballkanik dhe të sigurojnë zhvillimin, pronësinë dhe operimin eficient dhe të sigurt të Naftësjellësit Transballkanik brenda territoreve të tyre, të gjitha në pajtim me këtë Konventë, marrëveshjet dypalëshe, Marrëveshjen e Kartës së Energjisë dhe projekt marrëveshjet përkatëse.

Për këto arsye, është rënë dakord si më poshtë:

1. Përkufizime
- 1.1 Përkufizime

Termet me germa kapitale të përdorura në këtë Konventë (duke përfshirë hyrjen) dhe që këtu nuk përkufizohen ndryshe, kanë kuptimet e mëposhtme:

“Marrëveshje dypalëshe”

Është çdo marrëveshje që është lidhur ndërmjet një shteti, nga njëra anë, dhe një ose më shumë shoqëri projekti, nga ana tjetër, që përcakton të drejta dhe detyrime për këto Palë në lidhje me



<p>“Kontraktues”</p>	<p>Naftësjellësin Transballkanik. Është çdo person që ofron, drejtpërdrejt ose jo, mallra, punë ose shërbime për një shoqëri projekti ose investitor projekti në lidhje me Naftësjellësin Transballkanik.</p>
<p>“Data e hyrjes në fuqi” “Marrëveshja e Kartës së Energjisë”</p>	<p>Ka kuptimin e përcaktuar në nenin 23 të kësaj Konvente. Është Marrëveshja e Kartës së Energjisë, e hapur për nënshkrim në Lisbonë më 17 dhjetor 1994, që është në fuqi që prej datës 16 prill 1998.</p>
<p>“Monedha e huaj”</p>	<p>Është një monedhë lirisht e konvertueshme që tregtohet gjerësisht në tregjet ndërkombëtare të këmbimit të huaj dhe që përdoret gjerësisht në transaksionet ndërkombëtare.</p>
<p>“Komisioni i përbashkët”</p>	<p>Ka kuptimin e parashikuar në nenin 12 të kësaj Konvente.</p>
<p>“Të drejtat mbi tokën”</p>	<p>Janë ato të drejta për shqyrtimin, testimin, vlerësimin, analizën, inspektimin, ndërtimin, përdorimin, zotërimin, zënien, kontrollin, operimin dhe gëzimin në lidhje me tokën në territorin e çdo shteti, që mund të kërkohet për të zbatuar aktivitetet e Projektit në këtë shtet, duke përfshirë jo vetëm korridorin brenda, mbi ose nën të cilin ndodhet Naftësjellësi Transballkanik pas përfundimit, por edhe tokë shtesë dhe të drejta brenda këtij territori që mund të kërkohen nga investitorët e Projektit për qëllimin e vlerësimit dhe zgjedhjes së itinerarit dhe vendndodhjes së Naftësjellësit Transballkanik dhe ndërtimin dhe operimin e tij dhe në çdo rast, në pajtim me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e brendshme të këtij shteti.</p>
<p>“Humbje”</p>	<p>Është çdo humbje, përgjegjësi, dëm, gjobë, penalitet, tarifa të arsyeshme të avokatit ose konsulentit dhe disbursimet, pagesat ose shpenzimet që pësohen ose shkaktohen nga një person.</p>
<p>“Person”</p>	<p>Është një shoqëri, korporatë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ortakëri, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje, sipërmarrje e përbashkët, sipërmarrje e përbashkët e painkorporuar, shoqatë, trust ose subjekt tjetër juridik apo organizatë, e një natyre publike ose private.</p>
<p>“Naftë”</p>	<p>Është çdo hidrokarbur i lëngshëm, duke përfshirë, pa kufizim, naftën bruto, të kondensuar, naftën e papërpunuar, produktet e rafinuara që përftohen nga përpunimi i naftës bruto dhe lëngjet nga uzinat e gazit natyror.</p>
<p>“Projekt”</p>	<p>Është vlerësimi, zhvillimi, projektimi, përftimi, ndërtimi, instalimi, financimi, sigurimi, pronësia, operimi (duke përfshirë pa kufizim transportimin e çdo ose gjithë shoqërive të Projektit dhe dërgimin nga dërguesit e naftës nëpërmjet Naftësjellësit Transballkanik), riparimi, zëvendësimi, pajisja, mirëmbajtja, zgjerimi dhe mbrojtja e Naftësjellësit Transballkanik herë pas here.</p>
<p>“Aktivitetet e Projektit”</p>	<p>Janë aktivitetet në lidhje me Projektin e zbatuar herë pas here nga shoqëritë e Projektit, investitorët e Projektit, kontraktuesit, dërguesit dhe filialet e tyre përkatëse dhe subjektet e afiluar dhe nga të punësuarit, konsulentët, agjentët dhe përfaqësuesit e autorizuar të tyre.</p>
<p>“Marrëveshja e Projektit”</p>	<p>Është çdo marrëveshje kontratë dhe dokument tjetër në të cilin, nga njëra anë çdo autoritet përkatës dhe nga ana tjetër çdo shoqëri e Projektit ose çdo investitor(ë) i Projektit bëhet palë në lidhje me Projektin, si marrëveshje, kontratë ose dokument tjetër që mund të zgjerohet, rinovohet, zëvendësohet, ndryshohet apo modifikohet</p>

“Shoqëria e Projektit”	në një formë tjetër herë pas here, në pajtim me kushtet e saj. Është çdo person, i organizuar si duhet në bazë të ligjeve të një shteti, palë në një marrëveshje dypalëshe, i ndryshëm nga një palë në një marrëveshje të tillë dypalëshe me një shtet dhe çdo trashëgimtar ose person i lejuar i ngarkuar i një personi të tillë, në lidhje me Naftësjellësin Transballkanik.
“Investitori i Projektit”	Është një person, duke përfshirë pa kufizim çdo shtet që mban, drejtpërdrejt ose jo, një pjesë në kapitalin e një shoqërie të Projektit.
“Pjesëmarrës në Projekt”	Është një shoqëri në Projekt, një investitor në Projekt, një kontraktues, një dërgues ose çdo person tjetër që ofron mallra, punë, teknologji ose shërbime (duke përfshirë pa kufizim kredi, financim, siguracion ose shërbime të tjera financiare) për Projektin ose në lidhje me një pjesë të një aktiviteti Projekti.
“Autoritetet përkatëse”	Është secili dhe të gjitha autoritetet qendrore, federale, rajonale, lokale dhe të bashkive të një shteti dhe të gjithë elementet e tyre përbërës, pavarësisht nga ndonjë ndryshim i rrallë ose periodik në strukturë, formë apo tjetër, duke përfshirë të gjithë instrumentet, organet administrative dhe çdo dhe të gjitha organet, agjencitë ose departamentet ekzekutive rregullatore të bashkive dhe lokale, ose ministritë, autoritetet, nëpunësit e tyre ose tek ato, që kanë autoritetin të qeverisin, gjykojnë, rregullojnë, caktojnë apo mbledhin taksa, detyrime ose pagesa të tjera të japin licenca ose leje, apo të miratojnë ose ndikojnë (financiarisht ose ndryshe) drejtpërdrejt ose jo, mbi Projektin ose mbi çdo veprimtari të Projektit apo të drejtat dhe detyrimet e një pjesëmarrësi në Projekt në lidhje me Projektin.
“Transportues”	Është çdo person që ka rregulluar ose kontraktuar për transportin e naftës përmes të gjithë ose një pjesë të Naftësjellësit Transballkanik.
“Shtet”	Është një shtet sovran palë në këtë Konventë.
“Taksa”	Janë të gjitha tatimet, tarifatat, vlerësimet, pagesat dhe kontributet e ardhshme dhe të tashme, që i paguhen ose caktohen nga një shtet, një njësi e këtij shteti, qoftë qendrore ose lokale, ose një organ tjetër që ka autoritetin e ligjshëm për të caktuar këto taksa, tarifa, vlerësime, pagesa ose kontribute brenda territorit të këtij shteti dhe “Taksa” është çdonjëra prej tyre.
“Territor”	Është, në lidhje me një shtet, territori tokësor i këtij shteti, deti territorial, shelfi i saj kontinental dhe zona ekonomike ekskluzive mbi të cilën ky shtet ka juridiksion dhe ushtron të drejtat sovrane në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.
“Naftësjellës Transballkanik”	Është naftësjellësi që mbart naftë kryesisht, naftë bruto, i destinuar të fillojë nga bregu i Bullgarisë, përmes Maqedonisë, për në bregun e Shqipërisë, së bashku me terminalin, stacionet e pompimit dhe mjete të tjera që kërkohen për ta bërë këtë naftësjellës funksional dhe operativ, ku kuptohet që, në rastin e Bullgarisë, terminali në Burgas mund të jetë një terminal i përbashkët, që u shërben edhe naftësjellësve të tjerë si naftë bruto, rast në të cilin hyrja në të lejohet për shoqërinë e Projektit me një marrëveshje të përshtatshme Projekti ndërmjet pronarit të terminalit dhe kësaj shoqërie të Projektit; dhe
“Transit”	Ka kuptimin që i është dhënë në nenin 7(10)(a) të Marrëveshjes së Kartës së Energjisë.

Titujt në këtë Konventë nuk mendohen të jenë pjesë e saj dhe të merren parasysh në interpretimin ose ndërtimin e kësaj Konvente.

### 1.3 Njëjësi dhe shumësi

Fjalët që janë vetëm në njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas, nëse këtë e kërkon konteksti.

## 2. Detyrime dhe angazhime të përgjithshme

### 2.1 Përmbushja në kohë

Duke filluar nga data e fillimit, secili shtet i përmbush dhe i kryen në kohë të gjitha detyrat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo Konventë dhe nga çdo marrëveshje dypalëshe që është lidhur.

### 2.2 Përgjegjësia

Secili shtet respekton të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo marrëveshje dypalëshe që ai ka lidhur dhe merr të gjitha masat e ligjshme që mund të jenë të mundshme për të siguruar përputhjen e plotë me këtë Konventë dhe me çdo marrëveshje dypalëshe që ai ka lidhur dhe me çdo marrëveshje Projekti të lidhur nga autoriteti përkatës brenda territorit të tij.

## 3. Transiti

Kurdoherë që ka një situatë transiti, secili shtet siguron transitin e naftës përmes, për në, përgjatë dhe nga territori i tij me anë të Naftësjellësit Transballkanik dhe merr të gjitha masat dhe veprimet e arsyeshme, duke përfshirë ato të përfshira në Marrëveshjen e Kartës së Energjisë në këtë Konventë dhe Marrëveshjen dypalëshe të lidhur nga ky shtet për të përmbushur detyrimet e tij.

### 4. Titulli ose pronësia e naftës

Titulli ose pronësia e naftës së transportuar me anë të Naftësjellësit Transballkanik u mbetet shoqërisë(ve) zbatuese të Projektit, investitorit(ve) të Projektit dhe/ose transportuesit(ve), në pajtim me marrëveshjet e tyre tregtare.

## 5. Transiti i pandërprerë i naftës

### 5.1 Vazhdimësia

Secili Shtet, përveç raste kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjen dypalëshe që ai ka lidhur nuk ndërpret, kufizon, nuk cakton kushte apo pengon ndryshe rrjedhën e naftës me anë të Naftësjellësit Transballkanik në, përmes dhe/ose që del nga territori i tij dhe merr çdo masë që është e nevojshme për të parandaluar një ndërprerje ose kufizim të tillë apo një pengesë tjetër.

### 5.2 Njoftimi

Nëse një shtet merr, nuk merr ose pëson marrjen e një mase që ndërpret, kufizon, kushtëzon ose pengon rrjedhën e naftës me anë të Naftësjellësit Transballkanik në territorin e tij, ky shtet njofton menjëherë shtetet e tjera dhe shoqëritë përkatëse të Projektit për çdo ndërprerje, kufizim, kushte ose pengesa të tjera të tilla, për arsyet e kësaj dhe afatin kohor për pakësimin e saj dhe në rastin e një ngjarjeje të tillë, ky shtet eliminon arsyet që shkaktojnë ndërprerjen, kufizimin, kushtet ose pengesat e tjera dhe rivendos rrjedhën e pandërprerë, të pakufizuar, të pakushtëzuar dhe të papenguar të naftës me anë të Naftësjellësit Transballkanik në territorin e tij në mundësinë më të parë.

## 6. Standardet

### 6.1 Bashkëpunimi

Çdo shtet bashkëpunon me shtetet e tjera dhe shoqëritë e Projektit nëpërmjet përfshirjes së dispozitave të marrëveshjeve dypalëshe që ai lidh në lidhje me caktimin, formulimin dhe vendosjen e standardeve ndërkombëtarisht të pranueshme teknike, shëndetësore, cilësore për ambientin dhe sigurinë që duhet të respektohen gjatë zbatimit të aktiviteteve të Projektit në lidhje me Naftësjellësin Transballkanik, duke përfshirë fluksin e energjisë dhe magazinimeve përkatëse, që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e biznesit, përgjithësisht të pranuar brenda industrisë së naftës dhe *acquis communautaire*. Këto standarde, siç parashikohen në marrëveshjen dypalëshe të lidhur nga një shtet, janë të përshtatshme për kushtet dhe ambientin që mbizotëron në secilën zonë gjeografike të veçantë ku kalon Naftësjellësi Transballkanik dhe në maksimumin e mundshëm pas marrjes parasysh të dispozitave të veçanta të ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe dekreteve të brendshme të çdo shteti, harmonizohen me standardet e krahasueshme të parashikuara në marrëveshjet dypalëshe që janë lidhur nga shtetet e tjerë.

### 6.2 Konsultimi

Secili shtet konsultohet me shtetet e tjerë dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përputhjen me këto standarde të pajtueshme dhe ndërkombëtarisht të pranuar teknike, shëndetësore,

cilësore për ambientin dhe sigurinë, të formuluar, vendosura dhe harmonizuara në pajtim me këtë nen dhe të parashikuara në marrëveshjen dypalëshe që është lidhur nga ky shtet i cenuar.

### 6.3 Derdhja

Në rastin e derdhjes së naftës nga një pjesë e Naftësjellësit Transballkanik apo një ndodhi tjetër që shkakton apo mund të shkaktojë dëm material ose rrezik për shëndetin dhe sigurinë, me kërkesë të shtetit të cenuar dhe pa cenuar detyrimet e ndonjë shoqërie në Projekt në bazë të marrëveshjes dypalëshe të lidhur nga ky shtet, shtetet e tjera ndihmojnë shtetin e cenuar, menjëherë dhe në masën më të gjerë të mundshme, siç kërkohet nga shteti i cenuar. Komisioni i përbashkët vendos nëse shteti i cenuar është i detyruar të rimburojë shtetet e tjera për çdo humbje të shkaktuar gjatë dhënies së kësaj ndihme, duke marrë parasysh detyrimet e çdo shoqërie projekti në bazë të çdo marrëveshjeje dypalëshe që është lidhur nga ky shtet i cenuar.

## 7. Taksat

### 7.1 Trajtimi tatimor

Secili shtet siguron që trajtimi tatimor i çdo pjesëmarrësi në Projekt të mos jetë më pak i favorshëm se ai që zbatohet për sipërmarrësit vendas, në bazë të legjislacionit tatimor përgjithësisht të zbatuar në rrethana të ngjashme.

### 7.2 Bashkëpunimi

Në lidhje me masat për taksat, çdo shtet bashkëpunon me shtetet e tjerë për të siguruar një zbatim të drejtë dhe transparent të taksave për çdo pjesëmarrës në projekt dhe për të mënjeluar tatimin e dyfishtë.

### 7.3 Çmimi i transfertave

Në lidhje me llogaritjen e taksave, zbatohen parimet e caktimit të çmimit të transfertave që përmbahen në Udhëzimet e Caktimit të Çmimeve të Transfertave për Ndërmarrjet Shumëkombëshe dhe Administratat e Taksave OECD.

### 7.4 Nafta

Shtetet nuk vendosin taksa mbi vlerën e naftës që transportohet me anë të Naftësjellësit Transballkanik.

## 8. Detyrimet doganore

Çdo shtet u jep mallrave dhe shërbimeve të importuara që kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose jo me një veprimtari projekti, një trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jepet mallrave dhe shërbimeve të ngjashme me origjinë të brendshme ose të huaj dhe si anëtar i Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) zbaton rregullat e OBT-së për importet dhe materialet, dhe produktet e nevojshme për energjinë që kërkohen për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Naftësjellësit Transballkanik, duke përfshirë pa kufizim pajisjet e naftësjellësit.

## 9. Zbatimi i Projektit

Çdo shtet siguron mbështetjen e tij të plotë për zbatimin dhe zhvillimin e Projektit dhe çdo veprimtari projekti të parashikuar nga kjo Konventë dhe në marrëveshjen dypalëshe të lidhur nga ky shtet dhe përveç kësaj merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që çdo autoritet përkatës përmbush të gjitha detyrimet e caktuara për këtë autoritet përkatës me anë të kësaj Konvente dhe marrëveshjes dypalëshe që lidhet nga ky shtet ose me anë të një marrëveshjeje projekti të lidhur nga ky autoritet përkatës.

## 10. Bashkëpunimi

### 10.1 Kushtet e favorshme

Shtetet bashkëpunojnë me qëllim që të vendosin dhe ruajnë kushtet e nevojshme dhe të favorshme për ndërtimin, pronësinë dhe operimin nga shoqëritë e Projektit të Naftësjellësit Transballkanik dhe për transitin e naftës në dhe/ose përmes territoreve të tyre.

### 10.2 Konventa ose marrëveshje të tjera

Çdo shtet siguron bashkëpunimin e tij të plotë në realizimin e negocimit dhe lidhjes së këtyre konventave ose marrëveshjeve të tjera shumëpalëshe dhe dypalëshe, siç mund të jetë e përshtatshme ndërmjet shteteve dhe shteteve të tjera, institucioneve dhe autoriteteve ndërkombëtare, duke përfshirë

konsultim të hollësishëm me shoqëritë e projektit, me qëllim që të autorizohet, mundësohet dhe mbështetet zbatimi i Projektit dhe i gjithë veprimtarive të projektit.

## 11. Të drejtat mbi tokën dhe ujërat territoriale

### 11.1 Toka

Secili shtet siguron dhënien e të drejtave ekskluzive mbi tokën në territorin e tij dhe ruan kalimin në të për gjitha veprimtaritë e projektit në kushte dhe terma të drejta, transparente, të qarta dhe tregtare, sipas parashikimit të marrëveshjes dypalëshe të lidhur nga ky shtet dhe pas marrjes parasysh të dispozitave përkatëse të ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe dekreteve të brendshme të këtij shteti.

### 11.2 Ujërat territoriale

Secili shtet siguron dhënien dhe ruajtjen e hyrjes në portet detare dhe ujërat territoriale të këtij shteti për të gjitha veprimtaritë e projektit në terma dhe kushte tregtare të drejta, transparente dhe të qarta.

## 12. Komisioni i përbashkët

### 12.1 Ngritja

Ngrihet një komision që përbëhet nga dy përfaqësues nga secili shtet: (a) për të vëzhguar përmbushjen dhe lehtësuar zbatimin, realizimin dhe interpretimin e kësaj Konvente dhe Projektit; (b) për të lehtësuar dhe lejuar operimin e njëtrajtshëm dhe eficient të Naftësjellësit Transballkanik; dhe c) për të zgjidhur në mirëbesim çdo ndërlirim, çështje, problem ose mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me këtë Konventë ose Projektin (Komisioni i përbashkët). Secila shoqëri projekti ofron edhe dy vëzhgues për të asistuar në punën e komisionit të përbashkët.

### 12.2 Përfaqësuesit shtetërorë

Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e fillimit, çdo shtet u bën të ditur shteteve të tjerë përfaqësuesit e tij fillestarë në komisionin e përbashkët. Përfaqësuesit e një shteti autorizohen dhe u jepen kompetenca të plota nga ky shtet për të vepruar në emër të tij në lidhje me çdo çështje që sillt si duhet te komisioni i përbashkët në lidhje me Projektin. Secili shtet njofton me shkrim shoqëritë e projektit për përfaqësuesit e tij aktualë në komisionin e përbashkët. Secili shtet mund të ndryshojë përfaqësuesit e vet dhe kjo hyn në fuqi me dorëzimin e njoftimit me shkrim te shtetet e tjera.

### 12.3 Përfaqësuesit e shoqërive të projektit

Marrëveshja dypalëshe e lidhur nga secili shtet parashikon që shoqëria(të) e projektit palë në këtë marrëveshje dypalëshe t'u njoftojnë me shkrim këtyre shteteve dy vëzhguesit e tyre fillestarë në komisionin e përbashkët. Vëzhguesit janë plotësisht të autorizuar dhe me kompetencë nga shoqëria(të) e Projektit për të vepruar në emër të tyre në lidhje me çdo çështje që sillt rregullisht te komisioni i përbashkët në lidhje me Projektin. Një shoqëri e tillë projekti mund të ndryshojë vëzhguesit e saj dhe kjo hyn në fuqi me dorëzimin e njoftimit me shkrim tek shtetet dhe shoqëritë e tjera të projektit.

### 12.4 Rregullat procedurale

Komisioni i përbashkët miraton unanimisht rregullat procedurale në lidhje me takimet, aktivitetet dhe punën e komisionit të përbashkët.

## 13. Mosmarrëveshjet e kufijve dhe territoriale

Secili shtet bie dakord që: (a) detyrimet e tij për Projektin ekzistojnë pavarësisht nga ndonjë mosmarrëveshje, mospërputhje, pretendim, ndarje, rregullim, ndryshim ose modifikim tjetër në lidhje me vendndodhjen e një prej kufijve të tij ose përbërjen ose masën e territorit të tij që mund të ekzistojë tashmë ose që mund të lindë në të ardhmen apo të ndodhë ndërmjet tij dhe një shteti(eve) tjetër (për qëllimet e këtij neni, një "Mosmarrëveshje kufiri ose territoriale"); b) asnjë mosmarrëveshje kufiri ose territori ndërmjet cilitdo shteti nuk ndërhyt në asnjë mënyrë tek veprimtaritë e projektit; dhe (c) veçanërisht, detyrimet e parashikuara në Konventë nuk ndryshohen për shkak të një mosmarrëveshjeje kufiri ose territoriale që mund të lindë pas datës së fillimit.

## 14. Shpronësimi

Dispozitat e nenit 13 të Marrëveshjes së Kartës së Energjisë zbatohen *mutatis mutandis* për këtë Konventë dhe për të gjitha aspektet e Projektit.

## 15. Marrëveshjet dypalëshe

### 15.1 Termat dhe kushtet

Secili shtet merr përsipër të lidhë një marrëveshje dypalëshe me shoqërinë(të) përkatëse të Projektit. Secila nga këto marrëveshje dypalëshe bazohet në standarde dhe praktika ndërkombëtare, respekton në masën e duhur udhëzimet e përcaktuara nga Marrëveshja e Kartës së Energjisë, dhe ndërmjet të tjerash:

a) i jep kësaj shoqërie(ve) të Projektit, pasi merr parasysh dispozitat përkatëse të ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe dekreteve të këtij shteti dhe këtë Konventë, një të drejtë ekskluzive (qoftë me koncesion, francizë ose mjete të tjera të përshtatshme) për të projektuar, ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur Naftësjellësin Transballkanik në territorin e këtij shteti për një periudhë të caktuar vitesh, me të drejtat e zgjeruara të rëna dakord;

b) përcakton parametrat për hartimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Naftësjellësit Transballkanik në Territorin e këtij shteti, duke u kuptuar që Pala tjetër e shoqërisë së projektit në një marrëveshje dypalëshe i zgjedh kontraktuesit dhe dërguesit me të cilët hyn në kontrata të detajuara për projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Naftësjellësit Transballkanik në territorin e këtij shteti;

c) përcakton të drejtat dhe detyrimet e palës tjetër të shoqërisë(ve) së Projektit në një marrëveshje dypalëshe të tillë në lidhje me tokën dhe të drejtat e kalimit që përdoren për Naftësjellësin Transballkanik në territorin e këtij shteti;

d) përcakton ngjarjet që përbëjnë forcë madhore dhe vendos të drejta dhe detyrime për një shtet të tillë dhe këtë (këto) shoqëri projekti, nëse ndodh një ngjarje që përbën forcë madhore;

e) përcakton shkaqet e prishjes dhe vendos të drejta dhe detyrime për një shtet të tillë dhe një shoqëri projekti me prishjen e një marrëveshje të tillë dypalëshe;

f) parashikon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në bazë të një marrëveshjeje të tillë dypalëshe me anë të arbitrazhit ndërkombëtar;

g) vendos rregullat e pronësisë dhe rregullat e interkonjeksionit të Naftësjellësit Transballkanik në kufijtë ndërmjet shteteve dhe për marrjen nga një shtet i tillë të naftës për kërkesat e tij të brendshme;

h) vendos: i) tarifatat që duhet të caktohen për transitin e naftës përmes territorit të tij, tarifatat e të cilit mund të jenë të ndryshme në varësi të rrethanave në të cilat ato caktohen (për shembull, tarifa të ndryshme mund të caktohen në kontratat afatgjata të furnizimit nga tarifatat për transaksionet sporadike të tregut); ii) tarifatat në lidhje me përdorimin e porteve detare; iii) rregullat dhe procedurat për modifikimin e këtyre tarifave dhe pagesave; dhe iv) procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me to;

i) lejon palën tjetër të shoqërisë së projektit në këtë marrëveshje dypalëshe të financojë Projektin me anë të mjeteve të përbashkëta të huasë dhe kredisë dhe garantimit ndërkufitar të sendeve pasurore të projektit për të siguruar këto mjete, në çdo rast në pajtim me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e brendshme të këtij shteti;

j) lejon sendet pasurore dhe të drejtat e shoqërive të projektit dhe investitorëve në projekt, duke përfshirë pa kufizim, pjesën në kapital të një investitori projekti në një shoqëri projekti, të vihet në hipotekë, të vihet peng dhe/ose t'u cedohet huadhënësve si mjet garancie për shlyerjen e borxheve dhe kredive të dhëna nga këta huadhënës për financimin e projektit dhe për të lejuar shoqëritë e projektit për të depozituar të ardhurat dhe fitimet nga Projekti në llogari bankare që hapen jashtë territorit të këtij shteti si pjesë e një mase garancie në favor të këtyre huadhënësve, kurdoherë në pajtim me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e brendshme të këtij shteti;

k) i kërkon shoqërisë(ve) të Projektit të ndërtojnë dhe operojnë Naftësjellësin Transballkanik në pajtim me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e zbatueshme mjedisore;

l) përcakton tipet e shumave të sigurimeve dhe mbulimit që duhet të mbahen nga pala tjetër e shoqërisë(të) e Projektit në një marrëveshje dypalëshe dhe lejon këtë (këto) shoqëri projekti të marrin këtë siguri nga shoqëritë me reputacion të sigurimeve vendase dhe ndërkombëtare që përmbushin kriteret financiare të rëna dakord;

m) përcakton detyrime për një shtet të tillë në lidhje me sigurimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, mjeteve dhe instrumenteve të tjera infrastrukturore që kërkohen në lidhje me ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Naftësjellësit Transballkanik në territorin e këtij Shteti;dhe

n) përcakton termat dhe kushtet në të cilat transferohet Naftësjellësi Transballkanik në territorin e këtij shteti tek ky shtet me skadimin e afatit të kësaj marrëveshjeje dypalëshe.

### 15.2 Dispozitat e njëtrajtshme

Secili shtet bie dakord që marrëveshja dypalëshe për t'u ekzekutuar prej tij, pas marrjes parasysh

të dispozitave përkatëse të ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe dekreteve të tij të brendshme, do të jetë aq e ngjashme dhe e mundshme në formë dhe përmbajtje me marrëveshjen dypalëshe që do të ekzekutohet nga secili shtet tjetër, duke qenë qëllimi i shteteve të sigurojnë që në masën maksimale të mundshme, Projekti nga përmbajtja të trajtohet sikur ndodhet vetëm në një vend dhe sikur merret përsipër nga një subjekt i vetëm, megjithëse Projekti do të vendoset në territoret e tre shteteve dhe do të zbatohet nga më shumë se një shoqëri projekti.

#### 16. Qëndrueshmëria ligjore

Secili shtet bie dakord të mos marrë asnjë masë lidhje me Projektin ose një pjesëmarrës në projekt (duke përfshirë pa kufizim, modifikimin, revokimin ose miratimin e një ligji, rregulli, rregulloreje ose dekreti ose modifikimin, revokimin ose tërheqjen e një lejeje, miratimi ose autorizimi në fuqi në momentin që një pjesëmarrës në projekt fillon punën), që vetëm drejtpërdrejt dhe veçanërisht zbatohet për Projektin apo ndonjë pjesëmarrës në projekt dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të pritej të kishte efekt negativ mbi zhvillimin, zbatimin ose operimin e Projektit ose mbi pozicionin ligjor, ekonomik ose tregtar të këtij pjesëmarrësi në projekt.

#### 17. Monedha e huaj

Shtetet bien dakord që shoqëritë e projektit do të kenë të drejtën të rikthejnë në një monedhë lirisht të konvertueshme kapitalin dhe fitimet nga investimet në Projekt dhe kanë të drejtë të paguajnë principalin, interesin, tarifën ose pagesat e tjera në lidhje me borxhin që financon Projektin në valutë të huaj lehtësisht të konvertueshme.

#### 18. Qëllimi

Shtetet bien dakord që: (a) Projekti nuk do të ketë të bëjë me furnizimin me mallra ose shërbime për publikun e gjerë në territoret, për qëllimin e përmbushjes së ndonjë nevoje të gjerë ose të zakonshme të popullatës së shteteve ose të ndonjërit prej tyre; (b) Projekti nuk është i destinuar dhe nuk kërkohet për të operuar në shërbimin ose interesin e publikut në territoret e ndonjërit prej tyre; (c) as transporti dhe as transiti i naftës përmes Naftës-jellësit Transballkanik nuk do të kenë një transportues të përbashkët; dhe (d) përkatësisht asnjë marrëveshje dypalëshe nuk karakterizohet ose trajtohet, pjesërisht ose plotësisht, si një kontratë që jep një koncesion ose francizë për të operuar një ndërmarrje shërbimi publik apo të kërkojë në ndonjë mënyrë një tender publik për punët, mallrat ose shërbimet që përbëjnë të gjithë ose një pjesë të Projektit.

#### 19. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Shtetet përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj Konvente me anë të komisionit të përbashkët. Nëse, sipas mendimit të vetëm të një shteti dhe pavarësisht nga statusi i konsultimeve të bëra nga komisioni i përbashkët, një mosmarrëveshje nuk është zgjidhur, ai shtet, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar shtetit (eve) tjetër, mund t'ia paraqesë çështjen për një vendim përfundimtar dhe detyruet një gjykatë të posaçme. Një gjykatë e tillë e posaçme krijohet dhe e zhvillon gjykimin në pajtim me dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që përmbahen në nenin 27(3) të Marrëveshjes së Kartës së Energjisë, duke i zbatuar këto dispozita për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve *mutatis mutandis* për këtë Konventë.

#### 20. Pushimi i fuqisë

##### 20.1 Marrëveshjet dypalëshe

Kjo Konventë shfuqizohet në momentin e shfuqizimit ose skadimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe të gjitha marrëveshjeve të projektit dhe përfundimit të aktiviteteve të projektit sipas tyre ose në një mënyrë tjetër.

##### 20.2 Naftës-jellësi Transballkanik

Kjo Konventë shfuqizohet nëse ndërtimi i Naftës-jellësit Transballkanik nuk ka filluar në ose para përvjetorit të tretë të datës në të cilën të gjitha shtetet kanë lidhur marrëveshjet e tyre dypalëshe përkatëse dhe këto marrëveshje dypalëshe kanë hyrë në fuqi në pajtim me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e brendshme të shtetit përkatës.

Kjo Konventë mund të shfuqizohet nga shtetet nëse në bazë të termave dhe kushteve në lidhje me ndërtimin e Naftës-jellësit Transballkanik, duke përfshirë afatet për këto ndërtime të parashikuara në

marrëveshjet dypalëshe nuk janë përmbushur nga shoqëritë e projektit që janë palë në to, në pajtim me kushtet e marrëveshjeve dypalëshe.

21. Memorandumi trepalësh i mirëkuptimit

Shtetet njohin dhe bien dakord që konfirmimet e parashikuara nga seksioni 1 deri në seksionin 4 të Memorandumit Trepalësh të Mirëkuptimit të përmendura në hyrjen (B) të kësaj Konvente mbeten në fuqi dhe kanë efekt të plotë.

22. Ekzekutimi

Secili shtet ekzekuton katër (4) kopje origjinale të kësaj Konvente në gjuhën angleze.

23. Depozitari, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

23.1 Depozitari

Republika e Maqedonisë do të shërbejë si depozitari i një kopjeje të kësaj Konvente të ekzekutuar nga secili shtet dhe i një kopjeje të të gjitha dokumenteve të ratifikimit të miratuar nga secili shtet.

23.2 Ratifikimi

Kjo Konventë ratifikohet nga secili shtet në pajtim me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e tij të brendshme. Secili shtet njofton menjëherë Republikën e Maqedonisë si shteti depozitar për datën në të cilën ky shtet ka përfunduar të gjitha kërkesat në bazë të ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe dekretëve të brendshme për këtë Konventë që të hyjë në fuqi.

23.3 Hyrja në fuqi

Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë kalendarik pas datës në të cilën shteti i fundit ka njoftuar Republikën e Maqedonisë si shteti depozitar që ky shtet ka ratifikuar këtë Konventë në pajtim me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet e tij të brendshme (data e fillimit).

24. Amendimet

Kjo Konventë mund të amendohet nga Shtetet me anë të ekzekutimit nga secili shtet të një dokumenti me shkrim që përcakton termat e një amendimi të tillë dhe ky amendim do të ratifikohet dhe do të hyjë në fuqi në pajtim me procedurën e parashikuar në nenin 23 të kësaj Konvente.

Republika e Shqipërisë  
Nga \_\_\_\_\_  
Emri:  
Pozicioni:

Republika e Bullgarisë  
Nga \_\_\_\_\_  
Emri:  
Pozicioni:

Republika e Maqedonisë  
Nga \_\_\_\_\_  
Emri:  
Pozicioni:

**LIGJ**

**Nr.9782, datë 19.7.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM  
NDËRKOMBËTAR PËR PROJEKTIN E RRUGËS MILOT-RRËSHEN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar për projektin e rrugës Milot-Rrëshen”.



## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

### **Shpallur me dekretin nr.5436, datë 30.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**

#### **OFID FONDI I OPEC-UT**

#### **PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR HUA NR PROJEKTI I RRUGËS MILOT – RRËSHEN MARRËVESHJE HUAJE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR DATË \_\_\_\_\_, 2007**

Marrëveshje e datës \_\_\_\_\_ 2007 ndërmjet Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë i quajtur Huamarrësi) dhe fondit të OPEC-ut për zhvillim ndërkombëtar (këtu e më poshtë i quajtur OFID)

Ndërsa shtetet anëtare të OPEC-ut, duke qenë të ndërgjegjshme për nevojën për solidaritet ndërmjet të gjitha vendeve në zhvillim dhe të vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit financiar ndërmjet tyre dhe vendeve në zhvillim, kanë ngritur OFID-in për të dhënë mbështetje financiare për këto vende me terma të leverdishme, përveç kanaleve ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe me anë të të cilave shtetet anëtare të OFID-it e zgjerojnë asistencën e tyre financiare për vendet e tjera në zhvillim;

dhe ndërsa Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga OFID-i për financimin e Projektit, të përshkruar në planin kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje;

dhe ndërsa Huamarrësi i ka kërkuar edhe Bankës Botërore dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për ta asistuar në financimin e Projektit, duke dhënë për këtë hua;

dhe ndërsa OFID-i, ndërmjet të tjerash mbi bazën e sa më sipër, ka miratuar dhënien e një huaje për Huamarrësin në shumën e pesëmbëdhjetë milionë USD (USD 15 000 000), me termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë;

rrjedhimisht, Palët bien dakord sa më poshtë.

## Neni 1

### **Përkufizime**

1.01 Kurdoherë që përdoren në këtë Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Bloomberg Screen Page” është tregimi i kursit të interesave, zakonisht i njohur si LIBOR, për depozitat në dollarë në Londër, të caktuar si Page BBAM British Bankers Association (BBA LIBOR rates) e Shërbimit Bloomberg (ose një faqe tjetër që zëvendëson BBAM dhe tregon kursin ndërbankar të BBA Londër për depozitat në dollarë).

b) “Data e mbylljes” është data, sipas parashikimit të seksionit 2.10 të kësaj Marrëveshjeje, në të cilën pushon fuqinë e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Huaja.

c) “Dollari” ose shenja “\$” është monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

d) “Agjenci ekzekutuese” është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të Huamarrësit, ose një agjenci tjetër që mund të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe njësisë së menaxhimit të OFID-it.

e) “Data e hyrjes në fuqi” është data, sipas parashikimit të seksionit 7.01 të kësaj Marrëveshjeje, në të cilën Marrëveshja hyn në fuqi.

f) “Mallra” janë pajisjet, furnizimet dhe shërbimet e kërkuara për Projektin. Referenca në koston e mallrave mendohet të përfshijë edhe koston për importimin e këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit.

g) “Data e caktimit të interesit” është, nëse nuk parashikohet ndryshe në seksionin 2.02, dita e dytë e punës para fillimit të periudhës së interesit.

h) “Data e pagesës së interesit” është 15 mars dhe 15 shtator çdo vit.

i) “Periudha e interesit” është gjashtë (6) periudha gjashtë (6) mujore që fillon në një datë të pagesës së interesit para datës pasuese të pagesës së interesit, përveç rastit të periudhës së parë të interesit

që zbatohet për tërheqjen, kur tregon periudhën që fillon në datën në të cilën tërheqja bëhet dhe përfundon në ditën para datës pasuese të pagesës së interesit.

j) “Kursi i interesit” është kursi i interesit që paguhet për Huanë herë pas here, i përcaktuar në pajtim me seksionin 2.02.

k) “LIBOR” është për çdo periudhë interesi kursi i ofruar për dollarët që tregohet në Bloomberg Screen Page nën kolonën me titull “USD” në orën 11<sup>00</sup> para dite, ora e Londrës, në ditën përkatëse të përcaktimit të interesit për periudhën që është më afër kohëzgjatjes së kësaj periudhe interesi, me kusht që: (i) nëse, për një arsye, OFID-i nuk mund të përcaktojë kursin e interesit për një periudhë interesi në këtë kohë nëpërmjet referencës në BBAM Page, (për shkak të ndërprerjes së asaj faqeje ose për një arsye tjetër), OFID-i njofton menjëherë Huamarrësin dhe në vend të saj përcakton që kursi i interesit duke përdorur mesataren aritmetike (të rrumbullakosur nëse është e nevojshme në shifrën më të afërt 1/16%) të kurseve të ofruara për depozitat në dollarë në një shumë të krahasueshme me pjesët e Huasë të caktuara për të qenë të kërkueshme gjatë këtij interesi që i këshillohen OFID-it nga tre banka të mëdha që ushtrojnë aktivitetin në tregun ndërbankar të Londrës të përzgjedhura nga OFID-i; (ii) Nëse OFID-i përcakton që depozitat në dollarë nuk ofrohen në tregun ndërbankar në Londër në shumën të tilla ose për këto periudha apo kohëzgjatja e kësaj periudhe interesi është më e shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, kursi ndërbankar për një periudhë të tillë interesi i ngarkohet OFID-it për të financuar atë pjesë të Huasë të planifikuar për të qenë e kërkueshme gjatë kësaj periudhe interesi sikur OFID-i të kishte marrë hua atë pjesë të Huasë nga një burim i zgjedhur në mënyrë të arsyeshme nga OFID-i; dhe (iii) të gjitha përcaktimet e LIBOR-it nga OFID-i janë të padiskutueshme nëse nuk kanë gabime të dukshme.

l) “Hua” është huaja e dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

m) “Marzh” janë pesëdhjetë (50) pikë bazë.

n) “OFID” është Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar i ngritur nga shtetet anëtare të Organizatës së Vendeve për Eksportimin e Naftës (OPEC), në bazë të Marrëveshjes së nënshkruar në Paris, më 28 janar, 1976, e ndryshuar.

o) “Njësia e Menaxhimit të OFID-it” është Drejtori i Përgjithshëm i OFID-it ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

p) “Projekt” është projekti për të cilën jepet Huaja, sipas përshkrimit të planit kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas përshkrimit të tij që mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhimit të OFID-it.

## Neni 2

### Huaja

2.01 Një hua, në shumën pesëmbëdhjetë milion dollarë (15 000 000\$), i jepet nga OFID-i Huamarrësit me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshjeje.

2.02 Huamarrësi e paguan interesin e Huasë në dollarë, si më poshtë:

a) Gjatë çdo periudhe interesi, Huaja është me interes në atë kurs interesi, sipas përcaktimit të nënseksionit (c) më poshtë, për çdo periudhë interesi.

b) Interesi mblihet nga dita në ditë dhe llogaritet mbi bazën e një viti me treqind e gjashtëdhjetë ditë (360) për numrin aktual të ditëve në periudhën përkatëse të interesit dhe paguhet në këste në datën e pagesës së interesit menjëherë pas fundit të asaj periudhe interesi.

c) Kursi i interesit, për çdo periudhë interesi, është marzhi plus LIBOR-in.

d) Në çdo datë të përcaktimit të interesit për çdo periudhë interesi, OFID, në pajtim me nënseksionin (c) të mësipërm, përcakton kursin e interesit të zbatueshëm për periudhën e interesit dhe njofton menjëherë Huamarrësin.

e) Përcaktimi nga OFID-i, herë pas here, të kurseve të interesit është përfundimtar dhe i padiskutueshëm dhe e detyron Huamarrësin (nëse Huamarrësi nuk tregon në mënyrë të pranueshme për OFID-in që përcaktimi ka një gabim shkrimi).

2.03 Huamarrësi i paguan në dollarë OFID-it një tarifë detyrimi financiar në kursin e një gjysme të një përqindëshit (0.5%) në vit mbi pjesën e Huasë që, herë pas here, nuk është disbursuar ose anuluar. Tarifa e detyrimit financiar:

a) fillon të mblihet tridhjetë (30) ditë nga data e hyrjes në fuqi;

b) llogaritet në bazë të një viti me treqind e gjashtëdhjetë ditë (360) për numrin aktual të ditëve të kaluara; dhe

c) është i pagueshëm në dollarë dy herë në vit në këste në secilën datë të pagesës së interesit.

2.04 Huamarrësi i bën të gjitha pagesat e shumës principale, interesit, tarifave dhe çdo shumë tjetër që i detyrohet OFID-it në bazë të kësaj Marrëveshjeje në dollarë nga fondet e para që merr në atë bankë që OFID-i mund ta caktojë herë pas here. Pagesat duhet të pranohen në llogarinë që herë pas here caktohet nga OFID-i jo më vonë se 09<sup>00</sup> para dite, sipas orës së Nju-Jorkut.

2.05 Pasi kjo Marrëveshje të jetë deklaruar në fuqi në pajtim me seksionin 7.01, dhe nëse Huamarrësi dhe OFID-i nuk bien dakord ndryshe, shumat e Huasë mund të tërhiqen herë pas here për të mbuluar shpenzimet e bëra pas 19 dhjetorit 2006, ose që do të bëhen në datat e mëvonshme në lidhje me shpenzimet e arsyeshme të mallrave që kërkohen për Projektin, të cilat duhet të financohen nga shumat e Huasë sipas përcaktimit në planin kohor 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në amendimet e një plani kohor të tillë që miratohet rregullisht nga njësia e menaxhimit të OFID-it.

2.06 Përveç kur menaxhimi i OFID-it bie dakord ndryshe, tërheqjet nga Huaja mund të bëhen në monedhat në të cilat janë paguar ose janë të pagueshme shpenzimet e referuara në seksionin 2.05. Në rast se pagesa kërkohet në një monedhë të ndryshme nga dollari, kjo pagesë bëhet mbi bazën e kostos së tashme të dollarit të nxjerrë nga OFID-i në përmbushjen e kërkesës. Njësia e menaxhimit të OFID-it në blerjen e monedhave vepron si agjent i Huamarrësit. Tërheqjet në lidhje me shpenzimet në monedhën e Huamarrësit, nëse ka, bëhen në dollarë, sipas kursit zyrtar të këmbimit në kohën e tërheqjes, dhe në mungesë të një kursi të tillë, në pajtim me një kurs të arsyeshëm që njësia e menaxhimit të OFID-it e cakton herë pas here.

2.07 Të gjitha kërkesat për tërheqje përgatiten në dy kopje origjinale në pajtim me “Procedurat e Fondit të OPEC-ut për disbursimet e zhvillimit ndërkombëtar”, siç është aprovuar në maj të vitit 1983, një kopje e së cilës i është dhënë Huamarrësit. Një kopje origjinale e secilës prej këtyre kërkesave për tërheqje i paraqitet OFID-it nga përfaqësuesi i Huamarrësit i caktuar në, ose në pajtim me seksionin 8.02. Çdo kërkesë e paraqitur në këtë mënyrë shoqërohet me ato dokumente dhe prova të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të qenë të pranueshme për njësinë e menaxhimit të OFID-it që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga Huaja shumën e kërkuar dhe që shuma që do të tërhiqet do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2.08 Huamarrësi e shlyen shumën principale të Huasë në dollarë, ose në çdo monedhë tjetër lehtësisht të konvertueshme të pranueshme për njësinë e menaxhimit të OFID-it dhe në një shumë ekuivalente me shumën e kërkueshme të Dollarëve, sipas kursit të këmbimit të tregut që mbizotëron në kohën dhe vendin e shlyerjes. Shlyerja bëhet në tridhjetë këste gjysmëvjetore, që fillojnë me kalimin e periudhës pa pagesë prej pesë vjetësh, e llogaritur duke iu referuar datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe në pajtim me planin kohor të amortizimit të kësaj Marrëveshjeje. Çdo këst do të jetë në shumën prej (pesëqind mijë dollarë (USD 500 000)). Të gjitha këto këste transferohen në datën e shlyerjes të llogaria e OFID-it siç kërkohet nga njësia e menaxhimit të OFID-it.

2.09 (a) Huamarrësi merr përsipër të garantojë që asnjë borxh tjetër i huaj nuk do të ketë prioritet mbi këtë Hua në alokimin, realizimin ose shpërndarjen e këmbimit të huaj që mbahet nën kontroll ose në përfitim të Huamarrësit. Për këtë qëllim, nëse në një send pasuror publik krijohet një barrë (sipas përkufizimit të seksionit 2.09(c), si garanci për një borxh të jashtëm, që rezulton ose mund të rezultojë në një prioritet në përfitim të kreditorit të borxhit të jashtëm në alokimin, realizimin dhe shpërndarjen e këmbimit të huaj, barra, *ispsa facto*, dhe pa shpenzime për OFID-in, garanton në mënyrë të barabartë dhe proporcionale shumën principale dhe pagesat shtesë të Huasë, dhe Huamarrësi, gjatë krijimit ose lejjimit për krijimin e barrëve të tilla, e parashikon këtë shprehimisht; gjithashtu me kusht që, nëse për një arsye kushtetuese ose një arsye tjetër ligjore një parashikim i tillë nuk mund të bëhet në lidhje me një barrë të krijuar mbi sendet pasurore të një prej nënndarjeve të tij politike ose administrative, Huamarrësi menjëherë dhe pa shpenzime për OFID-in garanton shumën principale dhe të pagesave shtesë të Huasë me anë të një barre ekuivalente mbi sende të tjera pasurore publike të pranueshme për OFID-in.

b) Masa e mësipërme nuk zbatohet për:

i) çdo barrë të krijuar mbi një pasuri, në momentin e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së asaj pasurie; dhe

ii) çdo barrë që lind në rrjedhën e zakonshme të transaksioneve bankare dhe që garanton një borxh që maturohet jo më vonë se një vit pas datës së tij.

c) Siç përdoret në këtë seksion, termi “sende pasurore publike” janë sendet pasurore të Huamarrësit, ose të një nënndarjeje politike apo administrative të tij ose të një subjekti në pronësi ose të kontrolluar nga, ose që operon për llogari ose interes të tij, Huamarrësi ose një nënndarje e tillë, duke përfshirë edhe arin dhe sende të tjera pasurore të këmbimit të huaj të mbajtura nga një institucion që kryen funksionet e një banke qendrore ose fondi stabilizimi të këmbimit ose funksione të tjera për Huamarrësin.

2.10 E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga shumat e huasë e humb fuqinë më 31 dhjetor 2011, ose në një datë të mëvonshme që caktohet nga njëسيا e menaxhimit e OFID-it.

### Neni 3

#### **Ekzekutimi i Projektit**

3.01 Huamarrësi e zbaton projektin me kujdesin dhe efikasitetin e duhur në pajtim me praktikën e shëndosha administrative, financiare dhe inxhinierike dhe siguron, në kohën e duhur, fondet, ambientet, shërbimet dhe burimet e tjera, përveç shumave të Huasë, që kërkohen për këtë qëllim.

3.02 Huamarrësi siguron që aktivitetet e departamenteve dhe agjencive të tij në lidhje me zbatimin e Projektit të kryhen dhe bashkërendohen në pajtim me procedurat dhe politikën e shëndosha administrative.

3.03 a) Huamarrësi siguron ose merr masa të mjaftueshme përgatitore për sigurimin e mallrave kundër rreziqeve që mund të çojnë në përvetësimin, transportimin dhe dorëzimin e tyre në vendin e përdorimit ose instalimit dhe për këtë sigurim, çdo dëmshpërblim do të jetë i pagueshëm në një monedhë lehtësisht të përdorshme nga Huamarrësi për zëvendësimin ose riparimin e këtyre mallrave.

b) Me përjashtim të rasteve kur OFID bie dakord ndryshe, të gjitha Mallrat do të përdoren ekskluzivisht për Projektin.

c) Prokurimi i Mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë përgjithësisht në pajtim me dispozitat e “Udhëzimeve të prokurimit sipas Huave të dhëna nga Fondi OPEC”, siç është miratuar më 2 qershor 1982, një kopje e të cilës i jepet Huamarrësit ose në pajtim me këto procedura të tjera, që nuk janë të papajtuësme me to, siç mund të jetë e pranueshme për njësinë e menaxhimit të OFID-it.

3.04 (a) Huamarrësi do t'i japë menjëherë njësisë së menaxhimit të OFID-it, pas përgatitjes së tyre, planet, specifikimet, dokumentet e kontratës dhe programet e ndërtimit dhe prokurimit për Projektin dhe çdo modifikim ose shtesa materiale të tyre, sipas hollësirave që mund të kërkohen nga njëسيا e menaxhimit e OFID-it.

b) Huamarrësi:

i) do të mbajë të dhëna dhe procedura të mjaftueshme për të regjistruar dhe monitoruar ecurinë e Projektit (duke përfshirë koston e tij dhe avantazhet që lindin nga ky Projekt), për të identifikuar mallrat dhe për të bërë të njohur përdorimin e tyre në Projekt;

ii) do të mundësojë përfaqësuesve të OFID-it të vizitojnë mjediset dhe sheshet e ndërtimit të përfshira në Projekt dhe shqyrtojë mallrat dhe çdo të dhënë dhe dokument përkatës në lidhje me to; dhe

iii) do t'i japë njësisë së menaxhimit të OFID-it, në intervale të rregullta, të gjithë këtë informacion sipas kërkesës së arsyeshme të njësisë së menaxhimit të OFID-it në lidhje me Projektin, kostot e tij dhe sipas rastit, avantazhet që rrjedhin nga ky Projekt, shpenzimet e të ardhurave të Huasë dhe mallrat, si dhe një raport tremujor mbi ecurinë në zbatimin e Projektit.

c) Menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes ose ndonjë date të mëvonshme, siç mund të bihet dakord për këtë qëllim pas konsultimit ndërmjet Huamarrësit dhe OFID-it, Huamarrësi do të përgatisë dhe japë njësisë së menaxhimit të OFID-it një raport të kësaj fushe veprimi dhe sipas hollësirave që njëسيا e menaxhimit të OFID-it do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe operimin fillestar të Projektit, kostot dhe avantazhet që rrjedhin dhe që duhet të rrjedhin nga ky Projekt, përmbushjen nga Huamarrësi dhe OFID të detyrimeve të tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje dhe realizimin e objektivave të Huasë.

3.05 Huamarrësi do të ruajë ose do të kujdeset që të ruhen të dhëna të mjaftueshme për të reflektuar në përputhje me praktikën e ruajtura në mënyrën e duhur të llogaritjeve, operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me Projektin, të departamenteve ose agjencive të Huamarrësit, përgjegjëse për realizimin e Projektit dhe ndonjë pjesë të tij dhe do t'ia mundësojë ato sipas kërkesës njësisë së

menaxhimit të OFID-it.

3.06 Për sa kohë që është e pajtueshme me këtë Marrëveshje, Huamarrësi do të respektojë përkundrejt OFID-it të gjitha këto kushte, siç Huamarrësi pranon në Marrëveshjen e tij të Huasë, të nënshkruar ose që duhet të nënshkruhet me Bankën Botërore dhe IDA-n për financimin e pjesëshëm të Projektit, referencat ndaj çdo organizate në këto marrëveshje që çmohen për qëllimet e kësaj klauzole të jenë referenca ndaj OFID-it.

3.07 Të gjitha referencat ndaj Huamarrësit në këtë nen, do të interpretohen *mutatis mutandis*, si përfshirje të referencave ndaj agjencisë ekzekutive.

#### Neni 4

##### **Përfshirjet**

4.01 Kjo Marrëveshje dhe çdo marrëveshje shtesë ndërmjet palëve të saj do të çlirohet nga çdo taksë ose tatim të vendosur nga ose në territorin e Huamarrësit mbi ose në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose regjistrimin e tyre.

4.02 Principali i interesit dhe tarifave të tjera mbi Huanë do të paguhet pa zbritje dhe i çliuar nga çdo tarifë dhe kufizim të çdo lloji, të vendosur nga ose në territorin e Huamarrësit.

4.03 Të gjitha dokumentet e OFID-it, të dhënat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të çmohen konfidenciale nga Huamarrësi, për sa kohë që nuk bihet dakord ndryshe nga OFID.

4.04 OFID dhe asetet e tij nuk do të nënshtrihen ndonjë mase shpronësimi, shtetëzimi, sekuestrimi, ruajtje ose konfiskimi në territorin e Huamarrësit.

#### Neni 5

##### **Përfshirja e maturitetit; pezullimi dhe anulimi**

5.01 Nëse ndonjë prej ngjarjeve të mëposhtme do të ndodhë dhe do të vazhdojë për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo kohë të mëtejshme gjatë vazhdimit të asaj ngjarjeje, njësia e menaxhimit të OFID-it, duke njoftuar Huamarrësin, mund të deklarojë principalin e Huasë më pas të papaguar që të bëhet i detyrueshëm dhe i pagueshëm menjëherë së bashku me interesin dhe tarifën e tjera mbi të dhe në atë rast, principali së bashku me interesin dhe të gjitha tarifën do të bëhet menjëherë i detyrueshëm dhe i pagueshëm:

a) një mosplotësim pagese do të ndodhë dhe vazhdojë për një periudhë prej tridhjetë ditësh në pagesën e çdo kësti të principalit ose interesit ose të ndonjë tarife tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër në bazë të së cilës Huamarrësi ka marrë ose do të ketë marrë një hua nga OFID;

b) një mosplotësim pagese do të ndodhë në përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe ky mosplotësim pagese do të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh, pasi njoftimi për këtë do të jetë dhënë Huamarrësit nga OFID-i.

5.02 Me anë të një njoftimi drejtuar OFID-it, Huamarrësi mund të anulojë çdo shumë të Huasë që Huamarrësi nuk do të ketë tërhequr para dhënies së këtij njoftimi. Me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, OFID mund të pezullojë ose japë fund të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Huaja, nëse do të ndodhë ndonjë prej ngjarjeve të përmendura në Seksionin 5.01 (a) dhe (b) ose nëse e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas Bankës Botërore ose huatë e IDA-s të referuara në Preambulën e kësaj Marrëveshjeje, do të jenë pezulluar ose anuluar ose nëse do të ketë lindur ndonjë situatë tjetër e jashtëzakonshme që do të bëjë që Projekti të mos realizohet në mënyrë të suksesshme ose që Huamarrësi të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Pavarësisht nga përfshirja e maturitetit të Huasë sipas Seksionit 5.01 ose pezullimit apo anulimit të tij sipas seksionit 5.02, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç rasteve kur parashikohet specifikisht në këtë nen.

5.04 Për sa kohë që Huamarrësi dhe njësia e menaxhimit të OFID-it nuk bien dakord ndryshe, çdo anulim do të aplikohet pro rata për disa maturitete të shumës së principalit të Huasë që do të maturohet pas datës së këtij anulimi.

## Neni 6

### Zbatueshmëria, përfundimi i OFID-it, arbitrazhi

6.01 Të drejtat dhe detyrimet e palëve të kësaj Marrëveshjeje do të jetë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht ndonjë takse lokale në të kundërtën. Asnjë palë e kësaj Marrëveshjeje nuk do të autorizohet sipas ndonjë rrethane për të shpallur ndonjë pretendim që ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje të pavlefshme ose të pazbatueshme për ndonjë arsye të caktuar.

6.02 Njësia e menaxhimit të OFID-it do të informojë menjëherë Huamarrësin sa herë që merret ndonjë vendim për shpërbërjen e OFID-it, në përputhje me Marrëveshjen që themelon Fondin OPEC për zhvillim ndërkombëtar. Në rast të ndonjë shpërbërjeje të tillë, kjo Marrëveshjeje Huaje do të mbesë në fuqi dhe njësia e menaxhimit të OFID-it do të këshillojë Huamarrësin në lidhje me ndonjë marrëveshje zëvendësuese për shlyerjet e Huasë, siç mund të supozohet nga autoriteti përkatës i OFID-it në atë rast.

6.03 Palët e kësaj Marrëveshjeje do të përqipen të zgjidhin miqësisht të gjitha mosmarrëveshjet ose ndryshimet midis tyre që lindin nga kjo Marrëveshje ose në lidhje me të. Nëse mosmarrëveshja ose ndryshimi nuk mund të zgjidhen miqësisht, do t'i paraqiten arbitrazhit nga Gjykata e Arbitrazhit siç parashikohet më poshtë:

a) Procedimet e arbitrazhit mund të fillohen nga Huamarrësi kundër OFID-it ose anasjelltas. Në të gjitha rastet, procedimet e arbitrazhit do të fillohen me një njoftim të dhënë nga pala paditëse palës së paditur.

b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet prej tre gjyqtarësh arbitrazhi të emëruar si më poshtë: një nga pala paditëse, i dyti nga pala e paditur dhe i treti që nuk do të jetë me kombësi si të Huamarrësit (këtu e tutje i quajtur gjyqtar arbitrazhi) me marrëveshje të dy gjyqtarëve të arbitrazhit. Nëse brenda tridhjetë ditësh pas njoftimit të fillimit të procedimeve të arbitrazhit, pala e paditur nuk arrin të emërojë një gjyqtar arbitrazhi, ky gjyqtar arbitrazhi do të emërohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me kërkesën e palës që fillon procedimet. Nëse dy gjyqtarët e arbitrazhit nuk arrijnë të bien dakord mbi gjyqtarin e arbitrazhit brenda gjashtëdhjetë ditësh pas datës së emërimit të gjyqtarit të dytë të arbitrazhit, ky gjyqtar arbitrazhi do të emërohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

c) Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet në kohën dhe vendin e caktuar nga arbitri. Më pas, ajo do të vendosë për vendin dhe kohën kur do të mblidhet. Gjykata e Arbitrazhit do të përcaktojë të gjitha çështjet procedurale dhe çështjet në lidhje me kompetencën e saj.

d) Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të arrihen me shumicë votash. Vendimi i Gjykatës që mund të jepet edhe nëse njëra palë nuk plotëson pagesën, do të jetë i formës së prerë për të dyja palët e procedimeve të arbitrazhit.

e) Dërgimi i ndonjë njoftimi ose procesi në lidhje me ndonjë prej procedimeve sipas këtij seksioni ose në lidhje me ndonjë procedim për të zbatuar ndonjë vendim të dhënë sipas këtij Seksioni, do të bëhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 8.01.

f) Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë në lidhje me mënyrën në të cilën kostoja e arbitrazhit do të përballohet nga ndonjë ose të dyja palët e mosmarrëveshjes.

## Neni 7

### Data e hyrjes në fuqi; përfundimi i kësaj Marrëveshjeje

7.01 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën OFID-i i dërgon Huamarrësit njoftim për pranimin e tij të provave të kërkuara nga seksionet 7.02 dhe 7.03.

7.02 Huamarrësi do t'i japë OFID-it prova të mjaftueshme që:

a) ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit janë autorizuar në mënyrën e duhur dhe ratifikuar sipas kërkesave kushtetuese të Huamarrësit; dhe

b) marrëveshjet e huasë në lidhje me Bankën Botërore dhe huatë e IDA-s të referuara në Preambulën e kësaj Marrëveshjeje janë shpallur në fuqi ose do të shpallen në fuqi njëkohësisht me këtë Marrëveshje.

7.03 Në vijim të seksionit 7.02 (a), Huamarrësi do t'i japë OFID-it një vërtetim të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm ose departamenti kompetent ligjor i Huamarrësit që tregon se kjo Marrëveshje është autorizuar në mënyrën e duhur dhe ratifikuar nga Huamarrësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit në përputhje me kushtet e tij.

7.04 Nëse kjo Marrëveshje nuk do të ketë hyrë në fuqi dhe efekt deri më \_\_\_\_\_, 2007, kjo

Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve si më poshtë do të mbarojnë, për sa kohë që OFID, pas shqyrtimit të arsyeve për vonesën, do të caktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij seksioni.

7.05 Kur e gjithë shuma e principalit të Huasë do të jetë shlyer dhe interesi dhe të gjitha tarifatat që do të jenë shtuar mbi Huanë do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve si më poshtë, do të përfundojnë menjëherë.

#### Neni 8

#### **Njoftimi; përfaqësimi, modifikimi**

8.01 Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të jepet apo realizohet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim. Ky njoftim ose kjo kërkesë do të çmohen të jenë dhënë ose bërë në mënyrën e duhur kur i dërgohen dorazi, me postë ose telefaks palës së cilës i kërkohet të jepen ose bëhen, në adresën e palës të specifikuar më poshtë ose në ndonjë adresë tjetër që pala do t'i ketë specifikuar me shkrim palës që jep njoftimin ose që bën kërkesën.

8.02 Çdo veprim i kërkuar ose që lejohet të ndërmerret dhe çdo dokument i kërkuar ose që lejohet të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit, do të ndërmerret ose ekzekutohet nga Ministri i Financave i Huamarrësit ose ndonjë nëpunës tjetër i autorizuar nga ai me shkrim.

8.03 Çdo modifikim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të bihet dakord në emër të Huamarrësit nga instrumenti me shkrim i ekzekutuar nga përfaqësuesi i Huamarrësit, i caktuar nga ose sipas seksionit 8.02; me kusht që sipas mendimit të këtij përfaqësuesi, modifikimi është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

8.04 Çdo dokument i dorëzuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në ndonjë gjuhë tjetër do të shoqërohen nga një përkthim i tyre në gjuhën angleze, vërtetuar si përkthim i miratuar dhe ky përkthim i miratuar do të jetë përfundimtar ndërmjet palëve përkatëse.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar rregullisht, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet dhe dorëzohet në Vjenë në dy kopje në gjuhën angleze, secila origjinale dhe të gjitha për të njëjtin efekt të vetëm në ditën dhe vitin e shkruar fillimisht më sipër.

PËR HUAMARRËSIN:

Emri: \_\_\_\_\_

Adresa: Ministria e Financave  
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit  
Tiranë  
Republika e Shqipërisë  
Telefaks: 355 4 229200

PËR FONDIN OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR:

Emri: \_\_\_\_\_

Adresa: Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar  
P.O.Box 995  
A-1011 Vjenë  
Austri  
Telefaks: (43) 1 5139238

#### PROGRAMET

Programi 1: Përshkrimi i Projektit

Programi 2: Alokimi i Huasë

Programi 3: Programi i Amortizimit

#### REPUBLIKA E SHQIPËRISË

#### **PROJEKTI I RRUGËS MILOT- RRËSHEN**

#### PROGRAMI 1

#### PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti është ndërtimi i pjesës Milot-Rrëshen të korridorit të rrugës Durrës-Morinë brenda rrethit të Mirditës në Shqipëri dhe synon të zvogëlojë kostot e përdoruesit, duke përmirësuar sigurinë dhe aksesin dhe duke kontribuar kështu në uljen e varfërisë në zonën e Projektit.

Objektivat e Projektit do të arrihen nëpërmjet implementimit të komponentëve të mëposhtëm:

1. Punime civile dhe mbikëqyrje e konsulentit

Ky komponent përfshin ndërtimin dhe përmirësimin e 26.5 kilometrave të segmentit rrugor Milot-Rrëshen që do të ndërtohet si një autostradë e re me dy korsi. Ky segment rrugor përbëhet nga tre pjesë, njëri prej të cilëve është vënë nën menjanë për financimin nga Huaja e OFID-it.

2. Mirëmbajtja

Ky komponent përfshin pilotimin e kontraktimit të bazuar në përmbushjen e rezultateve për rrugët kombëtare në dy rajone në Shqipëri.

3. Siguria e rrugës

Siguria e rrugës do të përfshijë dhënien e asistencës teknike dhe mallrave për agjencinë ekzekutive si dhe Policinë Rrugore.

4. Asistenca teknike

Ky komponent përfshin financimin për:

- a) asistencën në krijimin e administratës detare,
- b) zbatimin e një ligji të ri autoriteti portual dhe përgatitjen e akteve të reja nënligjore detare, në pajtim me standardet e BE-së,
- c) ndërmarrjen e një vlerësimi në mirëbesim për sektorë specifikë, dhe
- d) mbështetjen e reformës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### PROJEKTI I RRUGËS MILOT-RRËSHEN

#### PROGRAMI 2 ALOKIMI I HUASË

1. Për sa kohë që Huamarrësi dhe njësia e menaxhimit të OFID-it nuk bien dakord ndryshe, tabela më poshtë përcakton komponentët që duhen financuar nga të ardhurat e Huasë, alokimin e shumave të Huasë për secilin komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që duhen financuar në lidhje me secilin komponent:

Komponenti	Shuma e Huasë së alokuar	Përqindja e shpenzimeve totale që duhen financuar (për t'u finalizuar) (Shprehur në dollarë amerikanë)
1) Punimet civile dhe mbikëqyrja	15,000,000	-----
2) Mirëmbajtja	-----	-----
3) Siguria e rrugëve	-----	-----
4) Asistenca teknike	-----	-----
Totali: 15,00,000		

2. Pavarësisht nga alokimi i një shume të Huasë ose përqindjet e disbursimit të përcaktuara në tabelën në paragrafin 1 më sipër, nëse njësia e menaxhimit OFID ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e Huasë më pas të alokuar për çdo komponent do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të të gjitha shpenzimeve në atë komponent, njësia e menaxhimit OFID, me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, mund të: (i) rialokojë në këtë komponent, në shkallën e kërkuar për plotësimin e deficitit monetar të vlerësuar, të ardhurat e Huasë që i alokohen më pas një komponenti tjetër dhe që për mendimin e njësisë së menaxhimit OFID nuk nevojiten për të plotësuar shpenzime të



tjera; dhe (ii) nëse kjo përqindje disbursimi nuk mund të plotësojë plotësisht deficitin monetar të vlerësuar, të ulë përqindjen e disbursimit më pas të zbatueshme për këto shpenzime, me qëllim që tërheqjet e mëtejshme në lidhje me këtë komponent të mund të vazhdojnë derisa të jenë bërë të gjitha shpenzimet e mëposhtme.

## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### PROJEKTI I RRUGËS MILOT- RRËSHEN

#### PROGRAMI 3

#### PROGRAMI I AMORTIZIMIT

Data e shlyerjes	Shuma e pagueshme ( E shprehur në dollarë amerikanë)	
1	15 mars 2012	500,000
2	15 shtator 2012	500,000
3	15 mars 2013	500,000
4	15 shtator 2013	500,000
5	15 mars 2014	500,000
6	15 shtator 2014	500,000
7	15 mars 2015	500,000
8	15 shtator 2015	500,000
9	15 mars 2016	500,000
10	15 shtator 2016	500,000
11	15 mars 2017	500,000
12	15 shtator 2017	500,000
13	15 mars 2018	500,000
14	15 shtator 2018	500,000
15	15 mars 2019	500,000
16	15 shtator 2019	500,000
17	15 mars 2020	500,000
18	15 shtator 2020	500,000
19	15 mars 2021	500,000
20	15 shtator 2021	500,000
21	15 mars 2022	500,000
22	15 shtator 2022	500,000
23	15 mars 2023	500,000
24	15 shtator 2023	500,000
25	15 Mars 2024	500,000
26	15 Shtator 2024	500,000
27	15 mars 2025	500,000
28	15 shtator 2025	500,000
29	15 mars 2026	500,000
30	15 shtator 2026	500,000
TOTALI:		15,000,000.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468  
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1.	KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2.	KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3.	REGJISTRAT E NOTERISË	
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii.	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi.	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

## TREGUES LEGJISLACIONI

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 30.7.2007  
Doli nga shtypi më 2.8.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 36 lekë